

MBROJTJA SOCIALE DHE QASJA NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PËR PERSONAT TRANSGJINORË NË KOSOVË

CSGD & CEL

Nëntor 2016



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Botuesi:

Koalicioni i të drejtave të barabarta për të gjithë – ERAC

Hulumtues:

Natyra Avdiu

Intervistues:

Nazmi Gashi

Bashkëpunëtorë:

Qendra për zhvillimin e grupeve shoqërore – CSGD

Qendra për barazi dhe liri – CEL

Dizajni & shtypi:

D.SH. In Graphics

Kopje:

XXX

Deklaratë Mohimi

Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ERAC dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Raporti është hartuar si pjesë e Koalicionit i të drejtave të barabarta për të gjithë (ERAC), i cili është një projekt katërvjeçar, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhohet nga BE në Kosovë. Ndër të tjera, Koalicioni mbështet Zyrën për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit në organizimin e procesit të hulumtimit, publikimin dhe prezantimin e dokumenteve të politikave në gjashtë të drejta themelore: të drejtën për barazi para ligjit; të drejtën për liri dhe siguri; të drejtën e lirisë së shprehjes; të drejtën për arsimim; të drejtën për punë dhe profesion; të drejtën për shëndetësi dhe mbrojtje sociale.

Të drejtat e autorit

© Koalicioni për të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC), nëntor 2016. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloj mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjim, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake të ERAC.



MBROJTJA SOCIALE DHE QASJA NË KUJDESIN SHËNDETËSOR PËR PERSONAT TRANSGJINORË NË KOSOVË

CSGD & CEL



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
HYRJE	9
METODOLOGJIA	11
KORNIZA JURIDIKE	12
Kushtetuta.....	12
Legjislacioni.....	12
Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.....	12
Ligji për Gjendjen Civile.....	13
Mbrojtja Sociale.....	14
Kujdesi Shëndetësor.....	15
Analizë e Kornizës Juridike.....	15
Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.....	16
Fokus Grupi.....	19
Të dhënat lidhur me pjesëmarrësit në Fokus Grup.....	19
Njohuritë lidhur me çështjet trans.....	19
Pengesat Individuale.....	19
Mbështetja dhe ndikimi.....	20
Ndërhyrja Kirurgjike për Ndryshimin e Gjinisë.....	21
Shikimi kah e Ardhmja.....	21
Mbrojtja Sociale.....	21
Të dhëna lidhur me të intervistuarit.....	21
Njohuritë lidhur me çështjet trans.....	22
Terminologjia: Seks apo Gjini.....	24
Ndërhyrja Kirurgjike për Ndryshimin e Gjinisë.....	25
Roli i Punëtorëve Socialë.....	27
Mbrojtja Juridike.....	28
Përvoja në mbështetjen e personave transgjinerë.....	30
Trajtimi i çështjeve të transgjinerëve.....	32
Qasja në kujdes shëndetësor.....	32
Të kuptuarit e çështjeve të transgjinerëve.....	34
Terminologjia: seksi apo gjinia.....	36
Ndërhyrja kirurgjike për ndryshimin e gjinisë dhe trajtimet tjera.....	37
Roli i profesionistëve shëndetësorë.....	39

Mbrojtja juridike.....	40
Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor për personat transgjnorë.....	41
Takimi me pacientin për të diskutuar tranzicionimin.....	43
Trajnimi dhe Informimi.....	44
PËRFUNDIM.....	45
REKOMANDIME.....	46

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë viteve të fundit janë shpërfaqur vështirësitë e komunitetit LGBTI dhe problemet me të cilat përballen pjesëtarët e këtij komuniteti janë duke u diskutuar më hapur. Personat transgjinatorë janë vetëm një pjesë e këtij komuniteti dhe për shkak të mungesës së njohurive ata mbesin individë që keqkuptohen nga të tjerët dhe ka të ngjarë të përballen me diskriminim në sfera të ndryshme të jetës.

Duke pasur parasysh kushtet dhe një situatë të tillë është porositur një hulumtim i cili ka rezultuar me këtë raport. Raporti merr parasysh elementet e ndryshme që përbëjnë termin gjithëpërfshirës/ ombrellë transgjinator, gjithashtu edhe kuadrin ligjor, përvojat e disa personave transgjinatorë (edhe pse të kufizuar në numër), si dhe mbrojtjen sociale dhe qasjen në shërbime shëndetësore.

Si nocion, termi transgjinator përfshin mënyra të ndryshme se si një individ mund ta shprehë identitetin e vet gjinor. Kjo mund të jetë në baza të përkohshme si transvestit ose përdorues i rrobave të gjinisë së kundërt apo në baza të përhershme duke iu nënshtruar trajtimeve hormonale dhe ndërhyrjeve kirurgjike. Mungesa e të kuptuarit se pse një individ mund të dëshirojë të shprehet në një identitet tjetër gjinor është një ndër shkaqet e paragjyqimeve ndaj tyre.

Personat transgjinatorë të përfshirë në këtë hulumtim ofrojnë disa pikëpamje lidhur me atë se si kanë filluar të shprehin identitetin gjinor, në të shumtën e rasteve duke u veshur me rroba të gjinisë së kundërt. Kjo rezultonte jo vetëm me keqkuptim por edhe me refuzim. Sidoqoftë, është e rëndësishme të veçantë për tu theksuar se pasojat e mos-pranimi apo refuzimit të tyre mund të rezultojnë me pasojat të rënda si vetë-lëndim apo vetëvrasje.

Përveç që ofron një kuptim të përgjithshëm të çështjeve, varësisht prej qasjes që aplikon ndaj personave transgjinatorë, korniza juridike mund të mundësojë ose pamundësojë realizimin e të drejtave të tyre. Korniza juridike në Kosovë ofron disa baza të mira, përmes të cilave njihen të drejtat e personave transgjinatorë ose ofron hapësirë për interpretim. Ndërsa në praktikë vetëm disa të drejta mund të ushtrohen në mënyrë efektive, si p.sh. duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithatë, siç është rasti edhe me ankuesit tjerë, lëndët e vjetra të grumbulluara në sistemin gjyqësor, mund të kthehen në pengesë në shqyrtimin e ankesave para gjykatave. Njëkohësisht, në rastet e tilla ka një sërë çështjesh tjera që duhet të merren parasysh, siç është ofrimi i ndihmës juridike dhe mundësisht sigurimin e konfidencialitetit përgjatë procesit. Në këtë aspekt, mund të bëhen disa përmirësime dhe ky raport i thekson disa prej tyre.

Në të njëjtën kohë, bartësit e përgjegjësive, detyrë e të cilëve është të ofrojnë shërbimet e tyre, gjithashtu kanë një ndikim të rëndësishëm. Mbi këtë bazë, janë shqyrtuar hollësisht dy sektorë, ai i mbrojtjes sociale dhe ai i shëndetësisë. Qëllimi ishte të identifikohen kushtet ekzistuese dhe në veçanti pikëpamjet e profesionistëve që kanë rol kyq në ofrimin e shërbimeve në kuadër të shërbimeve sociale dhe të kujdesit shëndetësor.

Sa i përket mbrojtjes sociale aktualisht nuk duket se ka ndonjë shtytje për tu marrur me këto çështje, ose madje as për ta identifikuar këtë si një çështje që duhet adresuar. Megjithatë, punëtorët social të intervistuar ofruan pikëpamje interesante lidhur me shërbimet e tyre për personat transgjinatorë. Për disa prej tyre çështja e ofrimit të asistencës për personat transgjinatorë kërkon qasje të fokusuar në të drejtat e njeriut, përderisa disa tjerë e shihnin këtë si ofrim të shërbimeve ndaj individëve transgjinatorë njësoj sikur ndaj pjesëtarëve të grupeve tjera të publikut.

Shumica e tyre demonstrojnë pranim të përgjithshëm të personave transgjinerë, edhe pse nuk është e qartë se sa janë të sigjerta pikëpamjet e shprehura.

Në sektorin e shëndetësisë, profesionistët shëndetësorë kishin disa njohuri lidhur me çështjen dhe se çfarë është roli i tyre. Disa kishin njohuri të kufizuara të kuadrit ligjor. Megjithatë, një numër i konsiderueshëm treguan përkushtim në ofrimin e asistencës së ndonjë personi që do të kërkonte më shumë informata lidhur me procesin e tranzicionimit. Për më tepër, kishte një gatishmëri nga disa prej profesionistëve që ata ose shkenca do të duhej të merreshin me këto çështje në vend të personave transgjinerë. Në anën tjetër disa profesionistë shëndetësorë haptas shprehnin mospajtimet e tyre për ndonjë lëvizje të tillë. Disa të tjerë madje kontestonin rolin e profesionistëve shëndetësorë në këto çështje dhe haptas shprehnin mospajtimin e tyre me të drejtat e transgjinerëve. Megjithatë, shumica e punëtorëve socialë dhe profesionistëve shëndetësorë shihnin përfitimin nga trajnimet, si dhe në punën në ekipe multi-disciplinare për t'i ofruar mbështetje individëve të prekur.

Raporti nxjerrë përfundimin se edhe pse është e dukshme se në disa fusha ka përparim, nuk duhet të jemi të kënaqur përderisa mund të bëhet më shumë. Në këtë drejtim, raporti ofron një sërë rekomandimesh, të cilat nëse zbatohen do të avancohen të drejtat e individëve për jetë private dhe e drejta e tyre për të jetuar një jetë me dinjitet.

Vështirësitë e personave transgjnorë¹ në Kosovë nuk janë të dokumentuara si duhet. Hulumtimi paraprak lidhur me liritë dhe mbrojtjen për lezbiket, homoseksualët, biseksualët, transgjnorët dhe interseksualët (LGBTI) gjeti se të drejtat e komunitetit LGBTI janë lënë pas dore duke i kushtuar kujdes të kufizuar nga institucionet shtetërore dhe nuk kishte shenja të dukshme të komunitetit LGBTI në jetën publike.²

Me qëllim të hedhjes dritë mbi perceptimet dhe përvojat e personave transgjnorë dhe trajtimit të tyre në sferën e mbrojtjes shoqërore dhe ligjore si dhe në kujdesin shëndetësor, ky raport synon të ofrojë kontribut drejt ofrimit të një pasqyre më të qartë lidhur me problemet më të përhapura dhe për të kërkuar ndryshime aty ku është e nevojshme me qëllim të përmirësimit të mundësive që personat transgjnorë të shprehin identitetin e tyre gjinor.

Një aspekt thelbësor, megjithatë, është shoqëria në të cilën një person transgjnor kërkon të shpreh identitetin tjetër të tij apo të saj. Ekspozimi i kufizuar i shoqërisë kosovare ndaj kësaj çështje si dhe mosdurimi i përgjithshëm që ekziston ndaj çdo gjëje që është ndryshe, nënkupton se nuk është fare e lehtë për një person transgjnor të hulumtojë dhe të shprehë tjetrin identitet gjinor të tij/saj. Duke marrë parasysh kushtet e tilla është e domosdoshme që ky raport të fokusohet në mbrojtjen sociale dhe kujdesin shëndetësor, pasi që këto janë dy sfera që mund të kenë ndikim të dëmshëm në personat transgjnorë dhe rrugëtimin e tyre, varësisht se si janë të organizuara shërbimet në këto fusha dhe nëse diskriminimi është pjesë përbërëse e shërbimeve dhe/apo mbrojtjes që ofrohet. Njëkohësisht, kuptimi i terminologjisë lidhur me personat transgjnorë është gjithashtu i nevojshëm me synim të ngritjes së vetëdijes dhe mirëbesimit në mesin e bartësve të përgjegjësive, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë.

Për të kuptuar termin transgjnor është e nevojshme të merren parasysh dy veçori: identiteti gjinor dhe seksual. Seksi është karakteristikë që caktohet me rastin e lindjes, pasi që çdonjëri nga ne është i lindur mashkull ose femër bazuar në karakteristikat biologjike.³ Në anën tjetër, identiteti gjinor është ndjenja e brendshme e individit e të qenit mashkull, femër, të dyjat, asnjëra apo diçka tjetër që jo detyrimisht është e dukshme nga të tjerët po që se nuk shprehet. Për shumicën e njerëzve seksi përcaktohet me rastin e lindjes dhe ata/ato vazhdojnë të jetojnë jetët e tyre në seksin e caktuar që korrespondon me identitetin e tyre gjinor. Termi transgjnor ka prejardhjen nga fjala latine trans që nënkupton "përtej". Personat që përshkruajnë veten si transgjnorë nënkuptojnë gjendjen kur identiteti gjinor i një individi, shprehja apo sjelljet nuk janë në përputhshmëri me seksin e tyre të caktuar me rastin e lindjes.⁴

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë "transgjnor është një term gjithëpërfshirës/ombrellë...Përfshinë njerëzit që janë transeksualë, transgjnorë, apo siç konsiderohen ndryshe

1 Ky raport dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (ang. Centre for Social Group Development – CSGD) ka përdorur fjalën transgjnor përgjatë këtij raporti pasi që beson që ky është termi më gjithëpërfshirës. Termit tjerë siç janë: transeksual apo transvestit përdoren për shkak të përdorimit të tyre historik në përcaktimin e asaj se çfarë nënkuptojnë të intervistuarit me ta kur përballen me problemet e komunitetit transgjnorë.

2 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, 'Liria dhe mbrojtja për Lezbiket, Homoseksualët, Biseksualët dhe Transgjnorët në Kosovë, Nëntor 2013, mund të gjendet në http://ks.yihr.org/public/fck_files/ksfile/LGBT%20report/Freedom%20and%20Protection%20for%20LGBT%20in%20Kosovo.pdf i qasur më 01/10/2016

3 Me përjashtim të individëve që janë interseksualë dhe caktimi i gjinisë është më i komplikuar.

4 Terminologjia e Qendrës Kombëtare për Barazinë e Transgjnorëve (ang. National Centre for Transgender Equality, Transgender Terminology), mund të gjendet në <http://www.transequality.org/issues/resources/transgender-terminology> i qasur më 01/10/2016

gjini e papërputhshme”.⁵ Gjithashtu mund t’i referohet edhe identiteteve tjera siç janë gjini variant (ang. gender variant), gjini e pazakontë (ang. gender queer) dhe transvestit (an. cross-dresser). Procesit përmes të cilit një individ mund të zgjedh të shprehë identitetin gjinor që është i ndryshëm prej atij seksual i referohemi si tranzicionim. Ky mund të përfshijë ndryshimin se si një individ vishet ose sillet apo ndryshimin e emrit. Gjithashtu mund të përfshijë ndërmarrjen e hapave për ndryshimin e dokumenteve identifikuese për të reflektuar identitetin e tyre gjinor. Disa persona transgjinorë mund të vendosin të kërkojnë trajtim mjekësor si terapi hormonale apo ndërhyrje kirurgjike.

Gjithashtu ka ndodhur edhe një ndryshim i qëndrimit në mesin e profesionistëve lidhur me atë se si konsiderohen personat transgjinorë sa i përket trajtimit të ofruar. Për shembull Shoqata Amerikane e Psikiatrisë në Doracakun Diagnostik dhe Statistikor të Çrregullimeve Mendore (origj. DSM-V) më parë i referohej individëve që kanë ndjenja të një gjinie tjetër si individë që vuajnë nga “çrregullimi i identitetit gjinor”. Kjo tanimë ka ndryshuar dhe tani i referohet si “shqetësim gjinor” (origj. gender dysphoria), që përdoret për të përshkruar shqetësim emocional. Ishte e nevojshme për të larguar përdorimin e terminologjisë që përdorej më herët, siç është termi ‘çrregullim’ që mund të shihej si stigmatizuese ndaj personave transgjinorë dhe fokusohej vetëm në diagnozë të shëndetit mendor.⁶

Të qenit transgjinor si koncept apo edhe si përvojë, pretendohet se akoma mbetet mistike apo edhe ofenduese për njerëzit.⁷ Mosidentifikimi me seksin e caktuar me rastin e lindjes mund të perceptohet si diçka ndryshe nga shoqëria në përgjithësi, edhe pse ndër vite, përmes kuptimit më të drejtë është rritur niveli i pranueshmërisë që personat të mund të jetojnë jetët e tyre në identitetin gjinor që i përfaqëson më së miri. Është e rëndësishme që pranueshmëria e tillë të bëhet e zakonshme në të gjitha komunitetet sepse në zemër të transgjinorizmit është e mishëruar përpjekja e individit në gjetjen e rrugës në jetë, duke qenë vetëvetja dhe duke qenë i/e kënaqur.⁸

Ky raport synon të sjellë në pah të dhëna lidhur me personat transgjinorë në Kosovë. Fillon me një përshkrim të metodologjisë që është përdorur për këtë hulumtim. Pasi që kuadri ligjor mund ose të mundësojë ose të ndalojë personat transgjinorë të shprehin identitetin e tyre gjinor, edhe kjo pikë është shqyrtuar. E rëndësishme së njëjtë është edhe qasja në mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor, që merret në shqyrtim duke shikuar në perceptimet e atyre që kanë për detyrë të ofrojnë mbrojtje sociale apo kujdes shëndetësor. Perceptimet dhe mungesa e njohurive lidhur me personat transgjinorë gjithashtu mund të ketë ndikim negativ dhe kjo është eksploruar gjithashtu përmes diskutimeve në fokus-grup. Duke vazhduar me një analizë të rezultateve të hulumtimit, raporti përmbillet me një përfundim dhe janë ofruar disa rekomandime.

5 Organizata Botërore e Shëndetësisë, mund të gjendet në <http://www.who.int/hiv/topics/transgender/en/> i qasur më 01/10/2016

6 “The APA Removes “Gender Identity Disorder” from Updated Mental Health Guide”, mund të gjendet në <http://www.glaad.org/blog/apa-removes-gender-identity-disorder-updated-mental-health-guide/> qasur më 28/11/2016

7 Teich N, ‘Transgender 101: A Simple Guide to a Complex Issue’, Parathënje

8 Ibid, Hyrje

METODOLOGJIA

Hulumtimi për këtë raport ishte konsideruar i nevojshëm në dritë të vëmendjes së kufizuar që i kushtohet problematikës së të drejtave apo përvojave të personave transgjnorë, qoftë në aspektin legjislativ, atë të politikave apo në diskursin publik në Kosovë. Qasja që është përdorur konsiston në hulumtim në zyrë dhe hulumtim në terren.

Hulumtimi në terren përfshin:

- Diskutimi në fokus-grup;
- Intervista me zyrtarë të mbrojtjes sociale; dhe
- Intervista me profesionistë shëndetësorë.

Fokus-grupi ka qenë i vogël dhe nuk mund të merret si mostër përfaqësuese. Për momentin nuk ka të dhëna zyrtare lidhur me individët që identifikohen si transgjnorë në Kosovë. Regjistrimi i popullsisë i pari pas konfliktit nuk përmbante pyetje lidhur me të dhëna mbi orientimin seksual e as për personat që identifikohen si transgjnorë.⁹Gjatë fazës planifikuese të hulumtimit ishte paraparë që të ftohet një grup më i gjerë i personave që përfshinte pjesëtarë të komunitetit LGBTI për diskutim në fokus-grup. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të mëtejshëm, me qëllim të sigurimit të rezultateve më cilësore, është vendosur që të ftohen vetëm individët që identifikohen ose kanë qenë të identifikuar si transgjnorë. Kjo e reduktoi dukshëm numrin nga përafërsisht 20 në 3. Për të siguruar që diskutimi në fokus-grup të jetë i strukturuar, u përdor një pyetësor dhe diskutimi u zhvillua në baza anonime me qëllim të krijimit të një mjedisi të hapur dhe të sigurtë për shprehje të mendimeve dhe pikëpamjeve. Diskutimi në fokus-grup u zhvillua në Prishtinë dhe ky vend u zgjodh me qëllim të shfrytëzimit të një lokacioni të njohur për komunitetin.

Me zyrtarët e mbrojtjes sociale gjegjësisht me punëtorët socialë janë zhvilluar intervista duke përdorur pyetësorët në baza anonime për tu siguruar që të kemi diskutime të sinqerta. Intervistat u zhvilluan në shtatë rajonet kryesore të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjilan. Këto rajone u përdorën gjithashtu për të zhvilluar intervistat me profesionistët shëndetësorë. Këto intervista gjithashtu u zhvilluan duke përdorur pyetësorë të ngjashëm dhe në baza anonime me qëllim të sigurimit të opinioneve sa më të sinqerta. Profesionistët shëndetësorë u zgjodhën në bazë të specializimit mjekësor nga të cilët personat transgjnorë do të mund të kërkonin ndihmë. Sidoqoftë, meqë specialistët mjekësorë nuk ishin të përfaqësuar në mënyrë të barabartë nëpër rajonet e mbuluara, nevojitej një qasje më pragmatike.

Shikuar statistikisht, numri i pjesëmarrësve në fokus-grup dhe profesionistëve të intervistuar është relativisht i vogël. Mund të jetë e kontestueshme se mostra e përdorur mund të mos jetë përfaqësuese në nivel kombëtar dhe një kufizim i tillë është i pranueshëm. Në të njëjtën kohë ka disa pengesa të identifikueshme që kanë pasur ndikim në këtë hulumtim. Një e tillë është mungesa e një komuniteti të hapur të transgjnoreve, që e bën shumë të vështirë konsultimin me ata si në fokus-grup ashtu edhe në intervista. Sa i përket profesionistëve të zgjedhur, ata përfaqësojnë një mostër më të mirë pasi që fokusohen në dy sfera që ky raport i kushton vëmendje të veçantë dhe fushat e veçanta të ekspertizës janë zgjedhur me kujdes. Megjithatë, madje edhe kjo mostër për të qenë përfaqësuese në nivel kombëtar do të mund të përmirësohej për të marrë pikëvështrime në nivel lokal në secilin prej rajoneve të zgjedhura.

⁹ Enti Statistikor i Kosovës, Regjistrimi i Popullsisë 2011, mund të gjendet në <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/> i qasur më 28/11/2016

Kushtetuta

Si një demokraci kushtetuese, vlerat kushtetuese të Kosovës përfshijnë barazinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimin që përçon një porosi të qartë që të gjithë qytetarët e saj duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, të drejtat e tyre njerëzore të respektohen pa diskriminim.¹⁰Vlerat e tilla janë të inkorporuara në të drejtat kushtetuese si barazia para ligjit që ofron trajtim të barabartë para ligjit për të gjithë dhe që secili gëzon të drejtën për mbrojtje të barabartë pa diskriminim.¹¹Për më tepër, Kushtetuta thekson se askush nuk mund të diskriminohet në bazë të një sërë karakteristikash, përfshirë këtu edhe gjininë apo statusin personal.

Të drejtat e njeriut dhe ato kushtetuese përbrenda sistemit juridik kombëtar janë fuqizuar më tej duke bërë të zbatueshme drejtpërdrejtë instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut siç është, ndër të tjera, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në rast të dispozitave kundërthënëse në fushën e të drejtave të njeriut ndërmjet masave në nivel kombëtar me të drejtat e mbrojtura me këto marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, këto të dytat mbizotërojnë.¹²Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kuadrit kushtetues është interpretimi i të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim Kushtetuta parasheh që të drejtat dhe liritë fundamentale të garantuara me Kushtetutë duhet të interpretohen në përputhshmëri me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

Përderisa Kushtetuta nuk i referohet specifikisht transgjinorëve apo identitetit gjinor, mund të argumentohet që ofron kornizë të rëndësishme ku të drejtat e personave transgjinorë janë të mbrojtura. Së pari, Kushtetuta parasheh që të gjithë personat gëzojnë të drejtën e mbrojtjes ligjore pa diskriminim dhe kjo përfshin edhe personat transgjinorë. Në rastet kur ligji nuk parasheh mbrojtje të tillë të barabartë, mund të argumentohet që kjo është në kundërshtim me atë që parasheh Kushtetuta. Së dyti, ndalimi i diskriminimit duke iu referuar gjinisë apo ndonjë statusi tjetër personal ofron hapësirë edhe për interpretim se kjo nëkupton ndalimin e diskriminimit në bazë të identitetit gjinor. Së treti, interpretimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në mënyrë konsistente me vendimet e GJEDNJ, që ofron fushëveprim më të gjerë për mbrojtjen e të drejtave të personave transgjinorë në Kosovë.

Legjislacioni

Pasi që ky raport synon të sjellë dritë për të drejtat e personave transgjinorë lidhur me qasjen në kujdes shëndetësor dhe mbrojtje sociale, pjesë të ndryshme të legjislacionit do të shqyrtohen gjithashtu.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Një nga pjesët kyçe të legjislacionit që është relevant për sigurimin e mbrojtjes adekuate në sfera të ndryshme për personat transgjinorë është Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.¹³Kosova

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 7 (1)

¹¹ Ibid, Neni 24 (1)

¹² Ibid, Neni 22

¹³ Ligji nr. 05/L-021

ka pasur legjislacion që ndalon diskriminimin që nga viti 2004¹⁴ i cili parashihte një kornizë të rëndësishme në ndalimin e diskriminimit në një sërë fushash. Megjithatë, siç është rasti me pjesën më të madhe të kuadrit ligjor në Kosovë, kishte problem në implementim.¹⁵

Ligji i fundit është mjaft i rëndësishëm pasi që përmirëson disa aspekte të caktuara nga ligji i vjetër, në veçanti ndalon diskriminimin në bazë të seksit, gjinisë apo identitetit gjinor, ndër të tjera.¹⁶ Duke ofruar edhe këto karakteristika siguron që personat transgjitorë janë të mbrojtur nga dispozitat e kesaj pjese të legjislacionit.

Zbatueshmëria e këtij ligji është e rëndësishme së veçantë pasi që mbulon veprimet apo lëshimet e të gjitha institucioneve shtetërore, personave fizikë dhe atyre juridikë në sektorin publik dhe privat. Kështu që jo vetëm institucionet qeveritare ose ndërmarrjet publike duhet të sigurohen që të veprojnë në pajtim me ligjin por edhe kompanitë private janë njësoj përgjegjëse. Për më tepër, ndalimi aplikohet ndaj një game të gjerë të fushave si: punësim (duke përfshirë qasjen, kushtet, promovimin etj.), trajnime dhe udhëzime profesionale, mbrojtje sociale (përfshirë asistencën sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore), përparësitë sociale, arsim, qasje në vendbanim, qasje dhe furnizim në të mira materiale dhe shërbime të cilat janë në dispozicion për publikun, trajtim të drejtë dhe të barabartë para organeve gjyqësore, të drejtë pjesëmarrje në shkencë dhe kulturë, siguri personale, pjesëmarrje në çështjet publike, qasje në vendet publike, dhe çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.¹⁷

Fusha të ndryshme janë të rëndësishme pasi që personat transgjitorë mund të përballen me diskriminim në kontekste të ndryshme përfshirë këtu rastin e qasjes në kujdes shëndetësor apo mbrojtje sociale, gjithashtu edhe në punësim, arsim, trajnime profesionale, qasje në vendbanim, vende publike, në blerjen e mallrave apo shërbimeve që janë në dispozicion për publikun. Në mënyrë të ngjashme, njohja e të gjitha të drejtave që parashihen me legjislacionin në fuqi është e rëndësishme së veçantë pasi që mundëson zbatim të këtyre të drejtave pa diskriminim. Për shembull, një prej fushave ku personat transgjitorë mund të hasin në vështirësi mund të jetë pranimi i identitetit të tyre gjinorë dhe në situata të tilla këto dispozita ligjore janë të rëndësishme për të marrur një rezultat pa diskriminim.

Ligji për Gjendjen Civile

Regjistrimi i gjendjes civile rregullohet me Ligjin për Gjendjen Civile.¹⁸ Ky ligj parasheh që të gjitha aktivitetet që lidhen me gjendjen civile duhet të ndërmerren në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore, shënimi i ngjarjeve të regjistruara në regjistrin e gjendjes civile nga autoritetet kompetente, është i detyrueshëm dhe subjektet e të dhënave duhet të regjistrojnë aktivisht çdo ndryshim që ndikon në gjendjen civile.¹⁹ Të dhënat që e përbëjnë gjendjen civile janë: emri personal, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja martesore, vdekja, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të përcaktuara me ligj.²⁰

14 Ligji nr. 2004/3, Ligji kundër Diskriminimit

15 Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë, 'Ligji Kundër Diskriminimit në Kosovë: shtatë vite pas', Dhjetor 2011, mund të gjendet në http://ks.yihr.org/public/fck_files/ksfile/Anti-Discrimination%20Law%20in%20Kosovo%20-%20seven%20years%20on.pdf i qasur më 01/10/2016

16 Neni 1, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi

17 Ibid, Neni 2

18 Ligji nr. 04/L-003

19 Neni 3, Ligji për Gjendjen Civile

20 Neni 9 (1), Ibid

Nga këto karakteristika disa nga të dhënat si emri dhe gjinia'mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ... vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër specifik."²¹Në të njëjtën kohë edhe ligji i referohet të dhënave që rrjedhin nga ngjarje natyrore duke paraparë që 'lindja, koha e lindjes, gjinia ... vërtetohen rregullisht si fakte juridike, nga personat dhe organet të cilëve iu njihet kjo e drejtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi!²² Me rastin e regjistrimit të lindjes, ku regjistrohet edhe seksi, kjo vërtetohet nga një raport mjekësor ose procesverbal i hartuar në kohën e lindjes. Verifikimi i lindjes, nëse jo në spital mund të bëhet nga zyrtarë të tjerë ose nëpërmjet Zyrës së Gjendjes Civile. Në rast se ka një çrregullim me organet gjenitale të një fëmije, gjinia përcaktohet nga një raport mjekësor.²³

Pas regjistrimit, lëshohet certifikata e lindjes ku ndër të dhëna tjera listohet edhe gjinia²⁴ dhe këto të dhëna në certifikatë të lindjes mund të ndryshohen drejtpërdrejtë nga zyrtari i gjendjes civile në rastet e përcaktuara shprehimisht në Ligjin për Gjendjen Civile dhe ligjet tjera në fuqi.²⁵Është me rëndësi që ligji e njeh mundësinë e ndryshimit të të dhënave të regjistruara në certifikatë të lindjes, që do të perfshinte edhe gjininë, dhe ky është një zhvillim pozitiv. Megjithatë, pasi që kjo lejohet vetëm kur specifikohet brenda Ligjit për Gjendjen Civile apo ndonjë ligj tjetër dhe aktualisht nuk ofrohen rrethana të tilla, kështu që në një të ardhme të afërt do të ishte e vështirë të arrihet. Mbi këtë bazë do të ishte e nevojshme që të sigurohet elaborim i mëtejshëm në mënyrë që një person transgjinior do të mund të mbështetet në një proces ku ai ose ajo mund ta ndryshojë seksin (përmes intervenimit kirurgjik për ndryshimin e seksit) për ta përshtatur me identitetin gjinior. Pas shqyrtimit të akteve nënligjore të specifikuara në Ligjin për Gjendjen Civile, çështja e procesit të ndërrimit të gjinisë aktualisht nuk ofrohet e as nuk rregullohet, çështje e cila duhet të zgjidhet me akt nën-ligjor. Mbi këtë bazë ndoshta do të duhej legjislacion i veçantë për të mundësuar ndërrimin e gjinisë me ligj që do të mund të mbulonte edhe korrigjimin e të dhënave në regjistrat publikë dhe dokumente, si dhe përshtatjen me të gjitha të dhënat tjera të regjistruara lidhur me individin qoftë ato lidhur me sigurimin social, pensionet apo taksat.

Mbrojtja Sociale

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare parasheh që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është përgjegjëse për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe duke bërë këtë duhet të sigurojë qasje të drejtë dhe të barabartë pa asnjë dallim të çfarëdo lloji, si në bazë të gjinisë apo ndonjë statusi tjetër. Ngjajshëm, MPMS është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe planeve strategjike për ofrimin e shërbimeve të tilla dhe këto politika dhe plane strategjike duhet të operacionalizohen nga komunat.²⁶

Në nivel lokal, roli i komunës është të ofrojë shërbime sociale dhe familjare sipas një standardi të përcaktuar nga MPMS. Secila drejtori është nën detyrim për të ndërmarrë hapa për identifikimin e natyrës dhe nivelit të nevojave për shërbime sociale dhe familjare. Ekziston një gamë e gjerë e shërbimeve që mund të ofrohen por për nevoja të këtij raporti ato që mund të jenë të rëndësishme janë shërbimet e këshillimit.²⁷Ofrimi i shërbimeve për personat madhorë parashihet në mënyrë specifike në ligj duke iu referuar kujdesit social, këshillimit dhe në raste të veçanta asistencës materiale.²⁸

21 Neni 10, Ligji për Gjendjen Civile

22 Neni 11, Ibid

23 Neni 32, Ibid

24 Neni 36 (3) (6), Ibid

25 Neni 38, Ibid

26 Neni 2, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligji nr. 02/L-17, i plotësuar dhe ndryshuar më 2012

27 Neni 6, Ibid

28 Neni 12, Ibid

Dispozitat e lartpërmendura parashohin disa obligime për bartësit e detyrave për të ndërmarrur hapat për identifikimin e shërbimeve që mund të nevojiten dhe të ofrojnë ato shërbime në kuadër të fushëveprimit të tyre. Për nevoja të këtij raporti me rëndësi janë shërbimet e këshillimit, edhe pse nuk ka të dhëna të mjaftueshme zyrtare që të mund të përcaktohet nëse merren parasysh dhe implementohen në mënyrë sistematike.

Një tjetër ligj i rëndësishëm është Ligji për skemën e ndihmës sociale në Kosovë. Ky ligj përcakton një skemë të ndihmës sociale bazuar në ndarjen e mjeteve sipas nevojës, edhe pse kjo kufizohet në dy kategori; familjet anëtarët e të cilave nuk janë të aftë për punë dhe ato tek të cilat një anëtar i familjes është i aftë për punë por ka një fëmijë nën moshën 5-vjeçare ose kujdeset për një jetim nën moshën 15-vjeçare.²⁹ Mendohet se skema e ndihmës sociale është kufizuese për shkak të mungesës së mjeteve financiare, edhe pse siç është e strukturuar aktualisht injoron individët në nevojë. Në rast se një individ ka nevojë për ndihmë financiare, e vetmja ndihmë që mund të jetë në dispozicion është diskreionale, përndryshe duhet të gjejnë mbështetje në bamirësi ose familje. Për disa individë si ata në gjendje të cënueshme kjo mund të jetë posaqërisht problematike.

Kujdesi Shëndetësor

Ligji për Shëndetësi³⁰ parasheh të drejtë të barabartë për të gjithë banorët për qasje në kujdes shëndetësor³¹ dhe siguron ofrim të kujdesit shëndetësor pa diskriminim mbi bazë të një sërë karakteristikash, përfshirë gjininë.³² Financimi i kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës bëhet sipas modelit të kombinuar të financimit, nëpërmjet buxhetit dhe sistemit të sigurimeve shëndetësore (publike dhe private).³³ Sigurimi shëndetësor rregullohet përmes Ligjit për Sigurim Shëndetësor.³⁴ Trajtim i barabartë dhe jo-diskriminues gjithashu parashihet në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.³⁵

Përderisa këto akte legislative parashohin trajtim jo-diskriminues, fokusi kryesor i tyre është kontributi drejt konsolidimit të sistemit të kujdesit shëndetësor, së fundmi me masat e ndërmarrura me fokus në themelimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore. Aktualisht Ministria e Shëndetësisë ka një strategji (2012-2016), e cila identifikon disa prioritete siç është ngritja e kapaciteteve,³⁶ edhe pse nuk fokusohet në ndonjë grup të veçantë që mund të jetë në disavantazh gjatë qasjes në kujdes shëndetësor ose që përballen me pengesa. Pasi që kjo strategji po i afrohet fundit, do të ishte hap i duhur që në strategjitë e ardhshme të identifikohen nevojat e grupeve të cënueshme dhe të planifikohen veprime për t'i adresuar këto dobësi si dhe për t'i eliminuar pengesat.

Analizë e Kornizës Juridike

Sa i përket kornizës juridike, një numër i akteve legislative tanimë janë në fuqi. Disa ofrojnë mbrojtje gjithëpërfshirëse siç është rasti me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, përderisa disa ligje tjera mund të përmirësohet me një plotësim të mëtejshëm siç është rasti me Ligjin për Gjendjen Civile. Legjislacioni që trajton mbrojtjen sociale ofron hapësirë lidhur me shërbimet që duhet ofruar

29 Neni 4, Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligji nr. 2003/15, i ndryshuar në 2012

30 Ligji nr. 04/L-125

31 Neni 4 (2), Ligji për Shëndetësi

32 Neni 5 (1) (2), Ibid

33 Neni 55 (1), Ibid

34 Ligji nr. 04/L-249

35 Neni 5, Ligji për Shëndetin Mendor, Ligji nr. 05/L-025

36 Mund të gjendet në <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-e-permiresimit-te-cilesise-dhe-sigurise-se-shqip,serb,ang-2012-2016.pdf> i qasur më 01/10/2016

personave madhorë por kjo gjithashtu mund të plotësohet me dokumente të politikave ku do të identifikoheshin grupet e cënueshme. Kjo gjithashtu reflektohet edhe në kujdesin shëndetësor ku duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje grupeve të marginalizuara përmes iniciativave dhe politikave.

Testi i vërtetë për secilën nga këto dispozita juridike, natyrisht do të ishte në fazën e zbatimit qoftë përbrenda institucioneve përkatëse, me rastin e përballjes me sfidat kur të drejta të caktuara nuk ofrohen apo nuk implementohen në nivel të kënaqshëm. Fatkeqësisht deri më tani kjo nuk ka ndodhur sa i përket të drejtave të personave transgjinerë dhe në dritë të këtij boshllëku, edhe pse mund të bëhen përmirësime në kornizën aktuale, është e nevojshme të merren parasysh sfidat me të cilat përballen personat transgjinerë nga vendet tjera. Kështu do të ofrohej njohuri se si sistemet e ndryshme i kanë trajtuar problemet e tilla përmes GJEDNJ. Kjo është e nevojshme pasi që disa nga problemet tanimë ose janë ekzistuese ose mund të shfaqen në Kosovë në një të ardhme dhe vendimet e GJEDNJ janë drejtpërdrejtë të zbatueshme po që se ndonjë lëndë e tillë do të dilte para gjykatave kosovare.

Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Dispozitat ligjore në secilin instrument juridik qoftë ndërkombëtar apo kombëtar janë të formuluar në terma abstraktë. Kjo është e nevojshme që këto dispozita të kenë mundësi të interpretohen në dritë të ndryshimit të rrethanave dhe dispozitat e tilla t'i rezistojnë testit të kohës. Një prej tyre është Neni 8 që parasheh që çdokush ka të drejtë t'i respektohet jeta private dhe familjare, shtëpia dhe korrespondenca dhe kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm në pajtim me ligjin dhe në rrethana të kufizuara. Interpretimi i kësaj dispozite është posaqërisht i rëndësishëm në dritë të të drejtave të personave transgjinerë.

Një prej rasteve të para të vendosura nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ishte Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar më 1986³⁷.

Me rastin e lindjes kërkuesja Brenda Rees kishte të gjitha veçoritë fizike dhe biologjike të seksit femëror dhe ishte regjistruar si femër. Megjithatë, në moshë të hershme fëmijërore filloi të shfaqte sjellje mashkullore dhe pasi që kuptoi se të qenit trans-seksual ishte gjendje mjekësore tanimë e njohur, kërkoi trajtim. Trajtimi përfshinte trajtimin hormonal dhe ndërhyrjen kirurgjike që financohej nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar dhe ndryshoi emrin në Mark Rees. Ai aplikoi që pasaporta e tij të reflektonte ndërrimin e identitetit gjinor pasi që ndryshimi i emrit veç ishte pranuar. Përkundër faktit se ai vazhdonte jetën si një burrë dhe pranohej si i tillë, ishte e pamundur për të korrigjuar të dhënat lidhur me seksin e tij në certifikatën e lindjes, ku akoma vazhdonte të figuronte se ai ishte femër. Mbi këtë bazë ai argumentoi se masat ligjore në nivel kombëtar e parandalonin të ushtrorë të drejtën e tij për jetë private dhe familjare dhe të drejtën e tij për tu martuar dhe krijuar familje.

Kërkuesi kërkonte ndryshimin në librat e regjistrimit civil mbi bazën se kjo do t'i mundësonte realizimin e të drejtave të tij njerëzore dhe se nuk kishte ndonjë arsytim mbi bazën e interesit publik për ta ndaluar këtë. Komisioni i cili trajtonte rastet para se të arrinin në GJEDNJ u pajtua me kërkuesin në vlerësimin e gjendjes. Megjithatë, Gjykata nuk e pranoi këtë arsytim dhe gjeti se duke kërkuar nga Mbretëria e Bashkuar që të ndryshojë rrënjësisht sistemin e regjistrimit të të dhënave në certifikata të lindjes ngarkon një barrë të rëndë dhe detyra të reja. GJEDNJ nuk mori parasysh faktin që trajtimi mjekësor u financua nga shteti dhe masa tjera të ndryshme siç

³⁷ Rees kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 9532/81, 17 Tetor 1986

është ndërrimi i emrit tanimë lejoheshin. Edhe pse gjeti se nuk kishte shkelje të së drejtës për jetë familjare, Gjykata u shfaq e vetëdijshme për problemet që preknin personat trans-seksualë dhe rekomandoi që ti mbante masat nën vëzhgim në dritë të zhvillimeve shkencore dhe shoqërore. Për sa i përket të drejtës për tu martuar dhe krijuar familje, Gjykata vendosi se nuk kishte shkelje, duke arsyetuar se martesë ishte koncept tradicional ndërmjet dy personave të seksit të ndryshëm biologjik dhe se shtetet kanë të drejtë ta rregullojnë të drejtën për tu martuar.

Pa dyshim kjo ishte një goditje ndaj luftës së këtij kërkuesi për të pasur identitetin e tij gjinor të njohur por edhe kishte implikime për personat tjerë në gjendje të ngjajshme në Mbretërinë e Bashkuar dhe shtetet tjera ku aplikohet praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Kjo linjë e interpretimit u pasua edhe në rastet tjera siç ishte rasti i Cossey kundër Mbretërisë së Bashkuar.³⁸ Megjithatë, Gjykata paksa e ndryshoi qasjen në rastin e B kundër Francës.³⁹ Kërkuesi ishte i lindur si djalë por përvetësoi sjellje femërore qysh në moshë të hershme dhe më vonë iu nënshtrua terapisë hormonale si dhe intervenimit kirurgjik për të filluar jetën si grua. Sidoqoftë, ajo nuk mund të korrigjonte dokumentacionin e gjendjes civile për të treguar ndryshimin të cilit i ishte nënshtruar dhe argumentoi para Gjykatës që kjo rezultonte me shkelje të të drejtave të saj për jetë private dhe familjare. Gjykata gjeti se ky rast do të mund të dallohej nga vendimet paraprahe në rastet Rees dhe Cossey mbi bazën se sistemi francez i regjistrimit të lindjeve lejonte përditësimet përgjatë jetës së individit. Gjithashtu, Gjykata vërejti se seksi i kërkueses ishte ndryshuar në disa nga dokumentet zyrtare, siç ishin dokumentet e sigurimit social dhe mos-harmonizimi i të gjitha dokumenteve e bënte jetën e kërkueses shumë të vështirë. Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi që refuzimi i autoriteteve të ndryshojë seksin e kërkueses në dokumentet ku lejohej ndryshimi i të dhënave rezultoi me shkelje të së drejtës për jetë private dhe familjare.

Gjykata shkoi një hap më tutje në rastin e Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar⁴⁰ kur përfundimisht ndryshoi praktikën e themeluar në rastet Rees dhe Cossey.

Kërkuesja, Christine Goodwin kishte lindur si mashkull, ishte i martuar dhe kishte fëmijë. Që nga moshë e re kishte një tendencë të vishej si grua dhe si i rritur i ishte nënshtruar terapisë hormonale dhe kishte filluar jetën si grua, si dhe i ishte nënshtruar ndërrimit të gjinisë përmes intervenimit kirurgjik që ishte ofruar dhe financuar nga Sistemi Kombëtar i Shëndetësisë. U divorcua nga ish-bashkëshortja por gëzonte dashurinë dhe përkrahjen e fëmijëve të saj. Në punë ishte ngacmuar seksualisht nga kolegët dhe tentoi të iniciojë procedura kundër ngacmimit seksual por ishte e pasuksesshme pasi që sipas ligjit ajo konsiderohej të jetë burrë. Gjithashtu u largua nga puna për arsye shëndetësore por ajo pretendonte që kjo u bë për shkak se ishte transeksuale. Duke pasur parasysh që seksi i saj figuronte në numrin kombëtar të sigurimit dhe departamenti qeveritar përkatës refuzonte ta ndryshonte këtë fakt, ajo u përballë me probleme në vendin e saj të ri të punës. Asaj gjithashtu iu komunikua që nuk do të mund të kualifikohej për pension shtetëror deri në moshën 65-vjeçare (mosha e pensionit për burra) kundrejt moshës 60-vjeçare (mosha e pensionit për gra), pasi sërish seksi i saj vazhdonte të mbetej ai që ishte regjistruar me rastin e lindjes, mashkull. U desh të heq dorë nga një numër benefitesh për shkak të seksit të saj që ishte regjistruar si mashkull kur në realitet ajo jetonte si një femër dhe nuk kishte mundësi t'i bënte këto ndryshime në dokumentacion për të reflektuar identitetin e saj gjinor. Kërkuesja argumentoi se mungesa e njohjes juridike të gjinisë së saj të ndryshuar dhe trajtimi i saj në punë, sigurim social dhe të drejtën e pensionit rezultonte me shkelje të së drejtave të saj për jetë private dhe familjare, të drejtën për tu martuar dhe krijuar familje.

38 Kërkesa nr. 10843/84, 27 Shtator 1990

39 Kërkesa nr. 13343/87, 25 Mars 1992

40 Kërkesa nr. 28957/95, 11 Korrik 2002, Dhoma e Madhe

Gjykata vërejti vështirësitë dhe anomalitë me të cilat kërkuesja dhe personat tjerë përballëshin. Gjykata deklaroi se para së gjithash vet thelbi i Konventës është respekti për dinjitetin njerëzor dhe liritë e njeriut të cilat sipas nenit 8 nocioni i pavarësisë personale është parim i rëndësishëm dhe ngërthen në vete edhe të drejtën e njeriut për ta krijuar identitetin e tij.

Gjykata vazhdoi tutje duke theksuar se "Në shekullin njëzet e një e drejta e transeksualëve për zhvillim personal dhe për siguri fizike dhe morale të ushtruar plotësisht sikurse ushtrohet nga pjesëtarët tjerë të shoqërisë nuk mund të llogaritet si kundërthënje që kërkon kohë për tu ndrikuar tërësisht këto çështje. Me pak fjalë, gjendja e pakënaqshme në të cilët personat transeksualë e përjetojnë në fazën post-operative si një zonë e ndërmjetme ndërmjet dy gjinive, nuk mund të jëtë më e qëndrueshme"⁴¹. Kështu, Gjykata nuk ishte e bindur se kishte vështirësi substanciale apo konkrete në dëm të interesit publik për t'i bërë ndryshimet e nevojshme në sistemin e brendshëm që do t'i mundësonte këto ndryshime për ata/ato me statusin e transeksualit dhe se "është e arsyeshme të pritet nga shoqëria të tolerojë një nivel të caktuar të shqetësimit në mënyrë që tu mundësohet individëve të jetojnë me dinjitet dhe vlerë në pajtim me identitetin seksual të zgjedhur nga ta me një çmim të lartë personal"⁴².

Gjykata rikujtoi se në rastet e mëparshme kishte theksuar rëndësinë e mbajtjes nën mbikëqyrje nevojën për masa të duhura në dritë të zhvillimeve shoqërore. Ky rast tregoi se kjo nuk ishte bërë dhe nuk ekzistonte asnjë plan për të ndryshuar situatën dhe mbi këtë bazë gjeti se kishte dështim në respektimin e të drejtës për jetë private të kërkueses. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata nuk ishte bindur se e drejta për tu martuar "duhet t'i referohet një përcaktimi të gjinisë nga kritere thjeshtë biologjike". Përderisa ishte në kompetencë të shtetit të përcaktojë formalitetet e martesave transeksuale, Gjykata gjeti se nuk ka "në asnjë rrethanë asnjë justifikim për ndalimin e transeksualëve për ta gëzuar të drejtën për tu martuar"⁴³.

Përparim i mëtejshëm sa i përket të drejtave të transgjinioreve është shënuar gjithashtu edhe duke u fokusuar në aspekte tjera. Në rastin e Van Kuck kundër Gjermanisë,⁴⁴ kërkuesja kishte inicuar procesin gjyqësor për të kërkuar kompensimin e shpenzimeve për ndryshimin e gjinisë përmes ndërhyrjes kirurgjike nga një kompani private e sigurimeve shëndetësore. Kërkuesja pretendonte se gjatë procesit gjyqësor kishte padrejtësi dhe se gjykatat vendore kishin shkelur të drejtat e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën e saj për jetë private dhe familjare. Gjykata gjeti se kërkuesja nuk kishte pasur gjykim të drejtë dhe se i ishte shkelur e drejta e saj për jetë private pasi që ishte disproporcionale të kërkohej nga kërkuesja të dëshmojë nevojën mjekësore për trajtimin që kishte marrë.

Sa i përket të drejtave të pensionit, përkundër vendimit në rastin e Christine Goodwin, që ishte pikë kthese në këtë fushë, dështimi për ta pranuar një kërkesë pas ndryshimit të identitetit gjinor mund të rezultojë me shkelje, siç është rasti i Grant kundër Mbretërisë së Bashkuar.⁴⁵

Dështimi në nxjerrjen e legjislacionit ose vonesat e gjata gjithashtu mund të jenë problematike dhe Gjykata trajtoi këtë çështje në rastin e L v Lithuania,⁴⁶ ku vonesat për më shumë se katër vite nga autoritetet lituaneze në nxjerrjen e legjislacionit që rregullon ndërrimin e gjinisë përmes ndërhyrjeve kirurgjike kishin rezultuar me shkelje të së drejtës për jetë private. Në mënyrë të

41 Ibid, para 90

42 Ibid, para 91

43 Ibid, para 103

44 Kërkesa nr. 35968/97, 12 Shtator 2003

45 Kërkesa nr. 32580/03, 23 Maj 2006

46 Kërkesa nr. 27527/03, 11 Shtator 2007

ngjashme, kufizimet arbitrare pa përfillur rrethanat e një rasti individual mund të rezultojnë në shkelje të së drejtës së jetës private, si në rastin e Schlumpf kundër Zvicrës.⁴⁷ Në këtë rast kompania e sigurimit shëndetësor të kërkueses nuk pranoi të paguajë shpenzimet e ndërhyrjes kirurgjike për ndërrimin e gjinisë pasi kërkuesja nuk kishte dashur të pres për së paku 2 vjet para operacionit, edhe pse kishte dështuar të marrë parasysh rrethanat, në radhë të parë moshën e kërkueses (67 vjeç), vendimi i së cilës do të ndikohej nga një vonesë e tillë dhe do të dëmtonte lirinë e saj për të përcaktuar identitetin e saj gjinor.

Fokus Grupi

Një diskutim i strukturuar është zhvilluar me tre persona, pjesëtarë të komunitetit transgjinorë lidhur me çështjet që i prekin më së shumti në çdo aspekt të jetës së tyre, qoftë personal apo profesional. Duke qenë të vetëdijshëm që ky numër është shumë i vogël, është shume e vështirë të nxirret një përfundim që ata përfaqësojnë komunitetin transgjinorë. Megjithatë, besojmë që në këtë diskutim në fokus grup pjesëtarët e këtij grupi kanë pasur mundësi të ndajnë informacione lidhur me vështirësitë me të cilat përballen në jetën e tyre të përditshme.

Të dhënat lidhur me pjesëmarrësit në Fokus Grup

Përderisa dy nga pjesëmarrësit janë të lindur si meshkuj, njëri nga ta është e lindur si femër; dy prej tyre janë në të njëzetat, njëri vetëm sa i ka mbushur 18 vjet. Që të tre i takojnë të njëjtit grup etnik (shqiptar-kosovar) dhe që të tre identifikohen si biseksual kur pyeten rreth orientimit të tyre seksual. Kur u pyetën se cilën gjini e preferojnë, që të tre deklaruan se preferojnë meshkujt. Përkundër faktit që të tre pjesëmarrësit thonë që jetojnë jetët e tyre si transgjinorë, ata deklaruan se hezitojnë të identifikohen si të tillë në shoqëri apo në familje. Arsyeja për këtë, sipas tyre, është për t'i evituar problemet e mundshme pasi që kjo kategori personash nuk është e mirëseardhur, në veçanti në qarqe familjare. Si përjashtim ata përmendin shokët/shoqet e ngushtë/a, që në raste të caktuara janë më përkrahës dhe më pranues se anëtarët familjeve të tyre.

Njohuritë lidhur me çështjet trans

Duke qenë pjesëtarë të këtij komuniteti të veçantë, pjesëtarët e fokus-grupit treguan njohuri relativisht të mira kur u pyetën për dallimin në mes termeve linguistike: transgjinor, transvestit dhe transeksual. Përderisa termi 'transvestit', sipas përgjigjeve të tyre, kryesisht lidhet me pamjen e jashtme apo të veshjes, përgjigjet e tyre dallonin kur provonin të shpjegonin se çka nënkuptonin me dy termat tjerë. Ishte e qartë që në thelb e kuptonin dallimin, megjithatë kishin vështirësi gjatë formulimit të përgjigjeve. Përgjigjet e tyre lidhur me dallimin në mes termave gjini dhe seks ishin më mirë të strukturuar dhe reflektonin njohuritë e tyre korrekte të kësaj çështje.

Pengesat Individuale

Që të tre respondentët përmendnin familjen dhe shoqërinë e gjërë si pengesën kryesore. Kjo bazohet në faktin se as familjet e tyre e as shoqëria në përgjithësi nuk bëjnë asnjë përpjekje për t'i kuptuar, por në të kundërtën preokupohen duke i paragjykuar dhe i penguar në rrugën e tyre për të zbuluar se kush janë. Ndikimi i familjes është një prej shtyllave kryesore, të rinjtë në veçanti vazhdojnë të mbështeten në familjet e tyre dhe vazhdojnë të kenë mbështetje ndër gjenerata. Mos-përshtatja me identitetin në familje si një transgjinor nuk e gëzon këtë mbështetje dhe mund të shkaktojë të gjitha llojet e vështirësive.

⁴⁷ Kërkesa nr. 29002/06, 09 Janar 2009

Një nga respondentët e rikujtoi një rast të fëmijërisë kur ishte veshur si nuse dhe kishte vendosur grim dhe ishte zbuluar nga nëna e tij. Ai tha se kjo nuk ishte një përvojë e mirë, pasi që ishte ndëshkuar për këtë, gjë që akoma e mban mend. Shfrytëzimi i lojrave të tilla për të shprehur identitetin gjinor ishte identifikuar si metodë e përdorur edhe nga respondentët tjerë gjatë fëmijërisë së tyre. Përmes kësaj mënyre respondentët gjithashtu u bënë subject i pikëpamjeve të tjerëve, përfshirë këtu edhe familje, që ishin të prirur të ishin kundër një shprehje të tillë të identitetit gjinor.

Një tjetër respondent rikujtoi se për vite të tëra, gjatë kohës kur ishte nxënës i gjimnazit, disa profesorë nuk ishin të vetëdijshëm lidhur me identitetin e tij gjinor. Ndërsa në universitet, sipas tij, fillimisht e mbante fshehur identitetin e tij gjinor deri sa vendosi të zbulohet, në të cilën pikë u shndërrua në një çështje serioze me të cilën duhej të merrej. Në vendin e punës, njëri nga respondentët përballej me ngacmime dhe shaka që i drejtoheshin, të cilat tërthorazi kishin konotacion negativ. Si rezultat i kësaj përvoje ai pati një diskutim me udhëheqësin e tij ku ngriti këto ankesa për të cilat nuk mori ndonjë përmirësim të gjendjes. Së fundmi njëri nga respondentët potencoi që madje ishte sulmuar fizikisht në një qytet për shkak të identitetit të tij gjinor.

Mbështetja dhe ndikimi

Pavarësisht se familja është një nga institucionet më të rëndësishme në Kosovë, realiteti për personat transgjinorë mbetet të qenurit i përjashtuar në baza të përhershme. Vetëm ky fakt që shkakton shumë stres në përgjithësi ka ndikim negativ mbi individët në fjalë. Njëkohësisht shumica e këtyre personave do të drejtojnë shikimin për mbështetje kah miqtë apo organizatat. Me rastin e një sulmi që kishte pësuar njëri nga respondentët, siç shpjegoi ai, kishte pranuar përkrahje nga njëra prej organizatave të komunitetit LGBTI në mënyrë që të përballej me atë që i kishte ndodhur.

Megjithatë, përkundër mbështetjes së kufizuar që ekziston, kjo nuk mund të jetë e mjaftueshme për ta parandaluar një individ nga të lënduarit e vetvetes apo madje edhe nga të konsideruarit e vetëvrasjes. Gjatë diskutimit në fokus-grup, kjo ishte njëra nga çështjet që u ngrit pasi që njëri respondent pohoi se kishte mendime vetëvrasëse e madje kishte tentuar një herë ta vrasë veten. Ai shpjegoi se tentativa e vetëvrasjes erdhi pas vuajtjes nga depresioni për muaj të tërë, pasi që kishte zbuluar identitetin e tij gjinor dhe ishte refuzuar vazhdimisht. Të gjitha këto ishin të tepërta për të sa që mendoi se nuk “do të mund të përballet më” dhe vendosi të ndërmarrë veprim. Në këtë pikë, familja filloi të përfshihet dhe fatmirësisht mbijetoi, megjithatë, pas kësaj ngjarje familja iu kthye avazit të vjetër duke e trajtuar atë si më parë dhe duke mos shprehur vullnet për ta pranuar identitetin e tij gjinor.

Për tu përballur me disa nga këto çështje, respondent i kishte vizituar edhe psikologun. Gjatë një seance për ta ngritur çështjen e identitetit gjinor ai iu referua një shoku që ishte homoseksual dhe para se ta përfundonte fjalinë i është thënë nga psikologu të mos elaborojë gjëra që nuk i ka provuar vetë. Për këtë individ të folurit lidhur me përvojën e shokut të tij me psikologun ishte një teknikë për ta testuar përgjigjen e një profesionisti dhe potencialisht t’i ndihmonte të hynte më thellë në thelb të problemeve me të cilat ai po përballej. Megjithatë, përgjigja që ky individ nuk duhet të diskutojë gjëra hipotetike dhe të jetë konkret lidhur me atë se çka i ka ndodhur apo se si ndjehej, disi ishte insenzitive. Kjo për shkak se madje edhe një psikolog kur punon me pjesëtarë të këtij komuniteti mund të thuhet se ka nevojë të ndërtojë një mirëbesim në mënyrë që të mund të ofrojë shërbime më të mira të mundshme. Qartazi, kjo lloj qasjeje nuk lejoi për një mirëbesim të tillë për tu ndërtuar, pasi që ky respondent e braktisi trajtimin me psikologun.

Ndërhyrja kirurgjike për ndryshimin e gjinisë

Respondentët u pyetën nëse ishte e mundur që dikush të ndryshojë gjininë dhe të gjithë u pajtuan që sipas mendimit të tyre për momentin kjo nuk është e mundur. Njëri nga respondentët potencoi se ky trajtim nuk është i mundur në Kosovë, e as në Shqipëri. Beogradi, u theksua se ishte përjashtim ku një trajtim i tillë është në dispozicion. Përveç mungesës së trajtimit mjekësor, një respondent tjetër theksoi se “janë kushtet e përgjithshme, rrethi juaj, përkrahja nga jashtë, familjes dhe shoqërisë”. Në thelb, ajo që respondentët i referoheshin ishte mungesa e mundësisë për trajtim duke u fokusuar në trajtim kirurgjik por duke përfshirë edhe terapinë hormonale. Në mënyrë të ngjashme, se si do të përceptohej një trajtim apo intervenim i tillë kirurgjik në shoqëri, familje dhe tek miqtë dhe përkrahja apo mungesa e saj nga institucionet relevante. Pa deklaruar në mënyrë të qartë, respondentët i referoheshin kushteve të cilat mund të përfshijnë çështje financiare, mungesën e mbështetjes dhe pranimit nga familja dhe miqtë, si dhe mungesën e mbështetjes nga institucionet e ndryshme siç janë ato shëndetësore. Sipas tyre, mungesa e këtyre kushteve do të bënte operacionin të vështirë edhe në qoftë se kjo procedurë do të kishte qenë në dispozicion.

Shikimi kah e ardhmja

Duke shikuar kah e ardhmja, respondentët u pyetën se çka do të duhej të bëhej që të përmirësohet gjendja e tyre në të ardhmen. Njëri prej rekomandimeve kryesore ishte ngritja e vetëdijes në mesin e profesionistëve, në veçanti tek psikologët shihet si e nevojshme në mënyrë që ata të mos e shohin dëshirën e një individi të shpreh identitetin gjinor apo për ndryshimin e gjinisë përmes intervenimit kirurgjik si një problem mendor dhe të mund të ofrojnë mbështetjen e tyre të nevojshme. Ngritja e vetëdijes është e nevojshme edhe në familje, roli i të cilave është i paçmueshëm nëse do të pranonin të drejtën e individëve të shprehen dhe të gjejnë atë që i bënë të ndihen rehat në kuptim të identitetit gjinor.

Mbrojtja sociale

Janë zhvilluar intervista të strukturuar me punëtorët social, si profesionistë që do të ishin më të thirrurit të ofrojnë mbështetje personave transgjinorë. Rezultatet janë shqyrtuar duke përdorur këto tri fusha: të dhënat lidhur me punëtorët socialë, njohuritë e tyre lidhur me çështjet trans dhe përvoja e tyre në përkrahjen e personave transgjinorë.

Të dhëna lidhur me të intervistuarit

Tabela 1

Mosha	Gjinia	Përkatësia etnike	Institucioni
41	Female	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
61	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
57	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
28	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
58	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
47	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale

50	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
58	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
58	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
64	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
27	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
56	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
36	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
27	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
59	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
52	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale
50	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra për Punë Sociale

Këto të dhëna u regjistruan si pjesë e hulumtimit për të krijuar një pasqyrë të atyre që intervistoheshin. Përderisa hulumtimi mbuloi rajonet kryesore të Kosovës siç është shprehur në metodologji, komponenta më e rëndësishme ishte moshë, që tregon se punëtorët socialë kryesisht janë të vjetër në moshë. Duke pasur para sysh kushtet në Kosovë, ky fakt mund të ketë ndikim negativ mbi bazën se është më pak e mundur që ata të kenë njohuri të përditësuar lidhur me çështjet e transgjitorëve, apo të përcjellin zhvillimet e fundit në këtë fushë dhe janë më pak të prirur për të qenë mendjehapur. Në të njëjtën kohë të gjithë respondentët janë kosovarë-shqiptarë, që gjithashtu është një faktor kufizues pasi që do të ishte e rëndësishme të kemi edhe pikëpamjet e komuniteteve tjera. Megjithatë, zgjedhja është bërë vetëm në bazë të rajoneve ku u zhvilluan intervistat me ata të cilët më me gjasë do të jenë në pozitë ose ti kenë ofruar shërbime ose do ti shërbejnë personave transgjitorë.

Njohuritë lidhur me çështjet trans*

Terminologjia mund të jetë e rëndësishme me rastin e përbaljes me një çështje të caktuar. Një nga pyetjet e para të shtruar në intervistat e strukturuar ishte të përcaktohet njohuria që të intervistuarit kishin në lidhje me termat në vijim: transgjitor, transvestit dhe transeksual dhe përgjigjet e tyre janë ta paraqitura me hollësi më poshtë.

Tabela 2

Intervista	Transgjitor	Transvestit	Transeksual
12	"Ndërrimi i gjinisë"	"Nuk e kuptoj"	"ndryshimi i organeve"
11	"personat që nuk i përka- sin një gjinie mashkull apo femër"	...	"ata persona që kanë tendenca për martesë me gjininë e një- jtë"
10	"transformimi prej një gjinie në tjetër"	"Nuk e kuptoj këtë term"	"ka ngjajshmëri – tranzicioni prej një gjinie në tjetër"

14	"kur një person për arsye të caktuara si i rritur vendosë të ndërrojë gjininë nga mashkulli në femër apo anasjelltas. Kjo vjen nga një dëshirë e brendshme për të qenë i gjinisë së kundërt, si diçka më shumë i gjinisë tjetër, ose për shkak se nuk ndjehet se është mashkull ose femër, apo në të kaluarën ka pasur trauma që kanë qar deri te ndërrimi i gjinisë".	"dëshira për të qenë i gjinisë tjetër"	"trans-seksual është kur don me ndryshu...Mendoj që i referohet të njëjtës temë... ndërrimin e gjinisë përmes medikamenteve, mjekësisë".
6	"ndërrimin e gjinisë"	"Nuk e di"	"ndërrimin e seksit"
5	"afiniteti për të dy gjinitë"	"Nuk kam dëgjuar"	"afinitetit për të dy sekset"
4	"persona homoseksuale – martesë në mes gjinive të njëjta: ai bjen qashtu?"	"Nuk e kam të qartë"	"të njëjtës gjini – nuk e kam të qartë"
16	"ndërrimi i gjinisë"	"ndërrimin e rrobave në bazë të gjinisë"	"ndërrimi i seksit"
15	"me këto terma jemi informuar përmes mediave, kemi pak informacione. Ka persona që gjinia apo seksi nuk është i përcaktuar"	"Nuk e kam dëgjuar këtë"	"përsëri kur seksi nuk është përcaktuar"
18	"...problem me seksin. Nënkupton femrat që kanë marrëdhënie vetëm me femra ose e kundërta, meshkujt me meshkuj"	"Nuk e di"	"mund të kenë marrëdhënie seksuale me gjininë e njëjtë apo të kundërt"
13	"Nuk e kuptoj kur gjinia transformohet...kur një femër martohet me një femër tjetër... ndoshta jam gabim po unë kështu e kuptoj"	"ka të njëjtin kuptim....trans..."	"është e njëjta si e para"
9	"Nuk kam ndonjë njohuri por kam dëgjuar për heteroseksualët dhe homoseksualët që domethënë prirjet e njerëzve për marrëdhënie seksuale me gjininë e kundërt apo të njëjtë..." Megjithatë në vazhdim të diskutimit i intervistuari tha se ka dëgjuar për meshkujt që ndihen si femra ose femrat që ndihen si meshkuj por nuk e njeh terminologjinë.		
8	"ndoshta preferencat biseksuale"	"Nuk e di"	"ndoshta biseksual"

7	"Unë thjesht e kuptoj që don me thanë një formë me ndër-ru gjininë, është lidhur me njerëzit që thjesht nuk ndihen mirë me atë që natyra i ka dhënë fizikisht, por dojnë të bëjnë ndryshime"	"...me ndërru gjininë"	"të trijat janë te ngjajshme... trans-seksual ndoshta është e njëjta me të dytën, prapë që deshiron me ndërru gjininë, diçka çashtu"
3	"ata që e ndërrojnë gjininë"	"s'kam ide"	"Nuk e di, të trijat po tingëllojnë njëjtë, me ndërru gjininë"
2	"... një individ që nuk është apo nuk dëshiron më të ketë gjininë që e ka dhe dëshiron me ndërru gjininë e tij"	"ndoshta për shkak se ai ose ajo e ka ndërru gjininë"	"Nuk mund të jap ndonjë sqarim sepse nuk jam ekspert i këtyre kategorive të përmendura"
1	"...personat... që janë homoseksualë"	"E pranoj që nuk e di"	"është lidhur me të parën...homoseksual"

Megjithëse ky raport dhe hulumtimi përdor termin transgjini si term gjithpërfshirës/ombrellë, këto tre terma janë përdorur për t'i lejuar të intervistuarve fushë më të gjerë për përgjigje. Rezultatet tregojnë që në përgjigjësi punëtorët socialë kanë hasur deri në një masë disa nga termat dhe kanë pak njohuri që lidhen veçanërisht me personat transgjini apo komunitetit LGBTI si tërësi. Është interesante që gjithashtu martesës iu referua në këtë drejtim dhe marrëdhëniet seksuale u përmendën në më shumë se një rast. Përafërsisht gjysma e tyre që u përgjigjën kanë ca njohuri se çka nënkupton të qenit transgjini, edhe pse kjo njohuri është mjaft e kufizuar. Termi transvestit siç duket shkakton më shumë huti me vetëm një përgjigje që potencon se i referohet mënyrës se si një person e shpreh gjininë e tij apo të saj. Përderisa përdorimi i këtyre termave ishte përdorur për të siguruar që sa më shumë respondentë të angazhohen në hulumtim pasi që ata do të mund të kenë dëgjuar për terma te ndryshëm, me sa duket përdorimi i transvestit dhe transeksual mund të ketë qenë hutuese. Përgjigjet në këte pyetje të veçantë gjithashtu duhet të interpretohen në dritë të përbërjes demografike më shumicën e punëtorëve sociale mbi moshën 40-vjeçare me disa prej tyre në të pësedhjetat dhe gjashtëdhjetat. Moshë e tyre është e rëndësishme pasi që përballja me këto terma mund të jetë e kufizuar.

Terminologjia: seks apo gjini

Një pyetje tjetër e rëndësishme ishte shtruar në bazë të terminologjisë lidhur me termet seks dhe gjini dhe se cilat janë dallimet në mes këtyre dyjave.

Tabela 3

Intervista	Seksi	Gjinia
12	"e njëjta si gjinia"	"mashkull ose femër"
11	"e njëjta" sikurse gjinia	"mashkull ose femër"
10	"seks ose gjini...mashkull ose femër...seksi dhe gjinia janë njëjtë"	

14	"...term biologjik, mashkulli ka organe të ndryshme"	"mashkull ose femër – titull shoqëror"
6	"e njëjta si gjinia"	"mashkull ose femër"
4	"marrëdhënie intime"	"...mashkull...femër"
16	"marrëdhënie seksuale midis atyre me gjini të kundërt "	"mashkull ose femër"
15	"kjo gjithashtu lidhet se cilës gjini i takon"	"...përcakton personalitetin e një individi – mashkull ose femër"
18	"...marrëdhëniet intime në mes sekseve të ndryshme apo të njëjta..."	"mashkull ose femër"
13	Marrëdhënie seksuale midis atyre me gjini të kundërt	"mashkull ose femër"
9	"...marrëdhëniet seksuale"	"...mashkull ose femër"
8	"është e njëjta..."	"mashkull ose femër"
7	"mua më duken që janë të njëjta si gjinia, kështu e kuptoj unë"	"ajo me të cilën je i lindur për shembull unë jam femër dhe kështu identifikohem, kjo është gjinia"
3	"në anglisht kur i referohemi seksit është e njëjtë si gjinia"	"mashkull ose femër"
2	"...ndoshta kjo mund të ndryshohet kurdo, varet nga orientimi që individi ka. Nje individ është i lindur me një gjini por cilin seks e dëshiron është vendim i tij, varet vetëm prej individit dhe askujt tjetër"	"... gjinia është ajo me të cilën ke lindur"
1	"...varet në dëshirën e secilit person për të zgjedhur, në veçanti pas moshës 18-vjeçare. Unë e kuptoj që ai ka të drejtë me kë të bëjë seks dhe në çfarë mënyre etj."	"... përcaktimi se çfare gjinie je... mashkull ose femër"

Të gjithë të intervistuarit kishin njohuri për të paktën njërin nga termat. Vetëm një pakicë i referohet faktit që seksi i referohet veçorisë biologjike që përcaktohet me rastin e lindjes, edhe pse të gjithë identifikonin këtë si mashkull ose femër. Kuptimi i gjinisë si ndjenjë e brendshme e individit nuk u përmend. Mungesa e përbaljes me të drejtat e transgjinitore mund të jetë një nga arsyet kryesore se pse të intervistuarit nuk ishin të familiarizuar me këto koncepte ose me atë që pyetjet synonin të nxjerrnin. Disa nga të intervistuarit i referoheshin marrëdhënieve ose preferencave seksuale. Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të çështjeve gjuhësore pasi që vetëm termi gjini ka tendencë të përdoret lidhur me karakteristikat mashkull apo femër në gjuhën shqipe, përderisa termi seks më zakonisht përdoret kur i referohet preferencave seksuale.

Ndërhyrja kirurgjike për ndryshimin e gjinisë

Pasi që një person transgjinitor mund të marrë vendim të ndryshojë duke iu nënshtruar intervenimit kirurgjik, pyetja që u shtrua ishte "Individët që dëshirojnë të ndryshojnë seksin e tyre duke iu

nënshtuar operacioneve kirurgjike, a do të duhet të ju mundësohet një gjë e tillë?" Për disa prej të intervistuarve kjo më shumë ishte çështje e zgjedhjes personale dhe nëse kjo është çfarë një individ dëshiron, do të duhej ti lejohej⁴⁸ apo "dëshira dhe vullneti i tyre" duhet të respektohet.⁴⁹ Çështja e moshës duket të ishte e rëndësishme gjithashtu për njërin nga të intervistuarit. Një punëtor social tha "ata të moshës madhore vendosin për vetëvete – ne nuk mund të përzihejmë".⁵⁰ Ndërsa një tjetër tha "varet nga moshë dhe nëse është i aftë për të kuptuar pasojat e vëprimeve të tij... për ata të rriturit, pa hezitim, përgjigja është pozitive".⁵¹ Një tjetër u pajtua se "një gjë e tillë, operacioni" do të duhej të ishte në dispozicion për personat mbi moshën 18-vjeçare pasi që "secili person ka të drejtë të vendosë për vete në çdo aspekt të jetës së tij... dhe kjo e drejtë shpresoj se ekziston në vendet tjera por edhe në vendin tonë".⁵²

Njëri i intervistuar iu referua qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në këtë çështje duke thënë se "si punëtor social... duke marrë parasysh të drejtat e njeriut që një individ duhet t'i mundësohet të mendojë dhe veprojë në pajtim me vullnetin e tij...nëse ai mendon...nëse është për mirëqënien e tij, pajtohem që do të duhej t'i mundësohej".⁵³ Në mënyrë të ngjashme, përgjigja e një tjetër punëtor social ishte "po, pse jo. Kjo është e garantuar me të gjitha konventat, konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut".⁵⁴ Një i intervistuar i tretë u pajtua se përgjigja duhet të ishte po në veçanti nëse individ "ka një dëshirë dhe vuan... është e drejtë njerëzore. Ndoshta do të ketë ndikim në pamjen dhe mirëqënien psikike... Unë e shoh të arsyeshme".⁵⁵

Të tjerët shihnin të drejtat individuale por gjithashtu përmendën konfliktin personal që mund të ngritet me rastin e trajtimit të kësaj çështje. Për shembull një punëtor social u shpreh "Unë mendoj se kjo nuk është praktikë për ne... të paktën në përvojën tonë pasi që është një çështje organike dhe mund të ketë pasoja. Sipas mendimit tim kjo është gabim. Nuk pajtohem me ndërhyrje të tilla...në aspekt shëndetësor, në aspekt fetar. Sidoqoftë kjo nuk varet nga ne; ne jemi nën detyrim të ofrojmë shërbime sociale të lejuara me ligj, etikë dhe profesionin tonë... personalisht une mendoj që në rrethin tonë dhe në mënyrën se si ne jetojmë kjo nuk është normale".⁵⁶

Një pikëpamje tjetër e cila nuk ishte plotësisht e fokusuar në individin ishte ajo që "këta persona konsiderohen si krijesa". Nëse do të kishte mundësi mjekësore për tu shëruar, do të ishte mirë të kontaktohen institucionet shëndetësore të mundësohet trajtimi. Por nëse ata dojnë të ndërrojnë gjininë e tyre, është përceptim i tyre; nuk mund ne të përcaktojmë se çka është e lejuar e çka jo. Duhet të jetë në vullnetin e tyre".⁵⁷ Në mënyrë të ngjashme, një i intervistuar tjetër u përgjigj po mbi bazën që "këta njerëz bëjnë atë që dojnë" duke krahasuar këtë lloj të procedurës me kirurgji plastike dhe "pasiqë ne i lejojmë homoseksualët të martohen, tash kjo është e drejtë e çdokujt".⁵⁸ Për një të intervistuar tjetër ndërhyrja nuk do të duhej të ishte një mundësi "nëse Zoti ka vendosur që ti je femër ose mashkull, nuk mund të shkosh kundër vullnetit të Zotit".⁵⁹

Përgjigjet e punëtorëve socialë në këtë pyetje ishin të ndryshme; prej atyre që mendonin se do të duhej ti qasen kësaj çështje nga aspekti i të drejtave të njeriut deri tek ata të cilët personat

48 Intervista 12

49 Intervista 11

50 Intervista 6

51 Intervista 5

52 Intervista 18

53 Intervista 14

54 Intervista 2

55 Intervista 13

56 Intervista 16

57 Intervista 15

58 Intervista 3

59 Intervista 1

trangjinorë i konsiderojnë si "krijesa". Përgjigjet e këtij grupit të dytë janë veçanërisht shqetësuese sepse një punëtor i tillë social nuk duket se do të ofronte përkrahje por me pikëpamje të tilla që përshkruajnë një viktimë të cënueshme mund të rezultojë me pasoja tragjike.

Një element tjetër i rëndësishëm është edhe mosha, për të cilën punëtorët socialë konsiderojnë që ndryshimi i gjinisë do të duhej të ishte mundësi vetëm për ata persona që janë madhorë. Një konsideratë tjetër e rëndësishme për disa punëtorë socialë është edhe feja, që është pengesë për të kuptuar çështjet e ndryshimit të gjinisë. Përderisa është e rëndësishme që këto çështje të ndryshme janë shprehur përgjatë intervistave, ato paraqesin një pasqyrë komplekse lidhur me pikëpamjet e punëtorëve socialë dhe në këtë fazë do të ishte e vështirë të thuhet nëse një individ do të mund të llogariste në mbrojtje nga punëtorët e tillë socialë. Një çështje tjetër me rëndësi për tu shqyrtuar do të mund të ishte edhe përgaditja profesionale e këtyre punëtorëve sociale, që nuk është konsideruar me këtë rast edhe pse kjo do të mund të kishte ndikim në pikëpamjet e tyre se si duhen trajtuar personat transgjnorë. Sidoqoftë është e nevojshme që në të ardhmen të punohet me punëtorët socialë në mënyrë që qasja e bazuar në të drejta të njeriut të zbatohet për gjatë gjithë procesit duke përcjellur informatat e fundit nga kjo fushë. Kjo duhet të përfshijë punën me institucionet e tjera në mënyrë që të hartohet një lloj plani lidhur me shërbimet në dispozicion, si dhe të zhvillohen shërbime që mund të ofrohen për t'i mbështetur personat transgjnorë.

Roli i punëtorëve socialë

Punëtorët socialë kanë rol të rëndësishëm kur një individ transgjnor kërkon mbështetje gjatë çdo faze të rrugëtimit të tyre në zbulimin e identitetit të tyre gjnor. Për këtë arsye punëtorët socialë u pyetën "A kanë profesionistët e mbrojtjes sociale, siç jeni ju, ndonjë rol në mbështetjen e personave transgjnorë? Nëse po, atëherë si?"

Një nga përgjigjet ishte se punëtorët socialë janë "në shërbim të të gjithë qytetarëve pa marrë parasysh gjininë, fenë, racën apo përkatësinë etnike"⁶⁰ duke treguar se ata do t'i përgjigjeshin këtyre sfidave. Për një punëtor tjetër social përgjigja ishte "po, natyrisht. Edhe pse jam në shërbim që 25 vjet nuk kam pasur një rast të tillë, nëse do të kisha mundësinë të ofroj mbështetjen time, do të bëja maksimumin".⁶¹ Në mënyrë të ngjashme, një tjetër punëtor social theksoi se "roli ynë është të përkrahim të gjithë ata që kanë nevojë. Sa i përket se si, unë e kam një pyetje këtu pasi që kjo mbetet temë tabu në shoqërinë tonë... por po, kushdo që kërkon një shërbim ne jemi këtu për të ofruar asistencë në pajtim me mundësitë dhe kapacitetet tona".⁶² Derisa një tjetër punëtor social deklaroi se nëse një palë vjen te ne "ne duhet të ofrojmë asistencën tonë si çdokujt tjetër. Pa marrë parasysh se çfarë kërkesë është shtruar, ne duhet të ofrojmë mbështetje".⁶³

Kushtet aktuale dhe presionet me të cilat përballen punëtorët socialë kanë ndikim në shërbimet që ata ofrojnë. Një punëtor social potencoi që "duke marrë parasysh rrethanat në të cilat jetojmë dhe qasja e profesionistëve më të moshuar ndaj këtij komuniteti, besoj se shërbimet që ne ofrojmë janë minimale por në kuadër të asaj çka në mund të ofrojmë. Nuk ka ndonjë dallim apo paragjykim por këto janë mundësitë në të cilat operojmë për momentin".⁶⁴

Shumë nga punëtorët socialë të intervistuar gjithashtu theksuan se kërkesa për t'i përkrahur personat transgjnorë ka qënë e ultë ose jo-ekzistuese. Një punëtor social potencoi se "nuk kemi

60 Intervista 18

61 Intervista 13

62 Intervista 9

63 Intervista 4

64 Intervista 2

pasur ndonjë rast të tillë që na është paraqitur... ne natyrisht i pranojmë të gjitha palët që kërkojnë asistencë.”⁶⁵

Megjithatë, ky rol nuk u pranua si i tillë nga të gjithë punëtorët socialë të intervistuar. Një punëtor social komentoi “jo, deri më tani nuk kemi pasur ndonjë rol për mbrojtjen e tyre”.⁶⁶ Një tjetër punëtor social theksoi se ata nuk kanë ndonjë rol pasi që “Qendra për Punë Sociale nuk ka ndonjë plan veprimi e as që kemi planifikuar të ofrojmë mbrojtje”.⁶⁷ Ky mendim ishte shprehur edhe nga punëtorë tjerë socialë.⁶⁸

Punëtorët socialë janë profesionistë të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes për personat transgjnorë qoftë atyre të rinjve apo të rriturve. Fakti që disa punëtorë socialë nuk konsiderojnë që kjo është brenda përgjegjësisë të punës së tyre, qoftë duke u bazuar në atë se nuk janë përballur me raste të tilla ose që ky grup është jashtë objektivit të tyre, është për tu shqetësuar. Përderisa duhet të pranohet që punëtorët socialë vazhdimisht duhet të përballen me një numër të lartë të rasteve dhe ju duhet të ofrojnë shërbime një sërë përfituesish që nga fëmijët deri tek të moshuarit, grupet e tilla si personat transgjnorë nuk duhet të përjashtohen. Siç është rasti me përfituesit tjerë, qendrat për Punë Sociale duhet që rregullisht të hartojnë dhe rishikojnë planet e veprimit përmes të cilave identifikohen përfituesit dhe ofrohen shërbimet. Kjo do të varet nga nevojat e secilës komunë edhe pse personat transgjnorë do të duhej të ishin nën kujdesin e tyre. Krahas planifikimit të tillë, qendrat për Punë sociale do të duhej të kenë ekspertizën profesionale me qëllim të ofrimit të shërbimeve të tilla dhe të kenë mjetet buxhetore të nevojshme për t’i ofruar shërbimet e tilla siç janë këshillimet dhe forma tjera të mbështetjes.

Mbrojtja juridike

Korniza juridike mund të jetë një mjet i rëndësishëm për komunitetin transgjnor. Një vetëdije më e lartë nga bartësit e detyrave është e rëndësishme jo vetëm për të siguruar që ofrohen shërbimet e duhura, por edhe në mbështetjen e anëtarëve të komunitetit që ata të realizojnë të drejtat e tyre. Mbi këtë bazë njohuritë lidhur me kornizën juridike gjithashtu është llogaritur si komponentë e rëndësishme dhe u hulumtua përmes intervistave me punëtorët socialë me një sërë pyetjesh.

Një punëtor social ishte i mendimit që edhe në Kosovë i ofrohen të drejtat komunitetit LGBTI por nuk ofroi ndonjë hollësi konkrete. Sa i përket të drejtave specifike u shfaqën pikëpamje kundërthënëse, për shembull ky punëtor social ishte kundër përshtatjes së seksit në pajtim me identitetin gjnor por mendonte se është e mundur që dikush të ndryshojë emrin në mënyrë ligjore dhe ishte në favor të kësaj nëse kjo ishte ajo që individi dëshiron. Më tej punëtori social deklaroi se personat transgjnorë nuk janë të cënueshëm e në veçanti pasi që ligji u lejon atyre të organizohen, e sa pranohen nga shoqëria është çështje tjetër.⁶⁹ Sa i përket cënueshmërisë, një tjetër punëtor social deklaroi se “është grup i cënueshëm... është fenomen që është diskutuar kohëve të fundit. Numri i personave të deklaruar është i vogël. Ata i kanë deklaruar disa probleme..kam përshtypjen që janë grup më i cënueshëm për dallim nga grupet tjera”.⁷⁰

Përbrenda sferës së mbrojtjes sociale një punëtor tjetër social theksoi se korniza juridike është mirë e konsoliduar. Megjithatë, u potencua që sa i përket procedurës së tranzicionimit korniza

65 Intervista 15

66 Intervista 3

67 Intervista 1

68 Intervista 12

69 Intervista 15

70 Intervista 5

juridike apo standardet profesionale mund të mos jenë të themeluara dhe ka të ngjarë të sjellin pasoja negative për rrethin dhe familjen e një personi pa ndonjë gjë pozitive. Ndërrimi i emrit është si mundësi, edhe pse kjo ka pak gjasa të jetë e suksesshme atëherë kur gjinia nuk mund të ndërrohet.⁷¹

Një punëtor social, lidhur me kornizën juridike theksoi se "Kam dëgjuar në media që po miratohet një ligj për martesë të së njëjtës gjini. Përderisa shoqëria kosovare është tradicionale, do ta ketë vështirë ta pranojë por duhet ta pranojë atë". Sa i perket mundësisë së tranzicionimit, ky punëtor social tha "E di që nuk mund t'ia ndërrosh gjininë dikujt pasi që operacioni nuk është i mundur" ndërsa ndryshimi i emrit është një veprim që mund të arrihet, edhe pse kur kjo ka ndodhur nuk ka qenë për shkak se personi ka qenë transgjinnor".⁷²

Përderisa korniza juridike shihet si adekuate nga një punëtor social, mbështetja që merr një person i cili dëshiron të bëjë ndërrimin e gjinisë është kyqe. Megjithëse në shoqërinë kosovare kjo është vështirë të ndodhë pasi që ka paragjykime nga shoqëria, njerëzit në përgjithësi dhe madje edhe familja. Ka vështirësi edhe në punësim, shkollim, në çdo aspekt të jetës. Si e tillë, korniza juridike mundet me qenë adekuate por zbatimi i saj nuk është, në veçanti atëherë kur pikëpamjet e shoqërisë kanë nevojë për ndryshim. Ky grup gjithashtu është i cënueshëm pasi që shpesh në shoqëri besohet se këta individë kanë probleme mendore. Ky është një gabim, por gjërat po ndryshojnë dhe gjeneratat e reja përfaqësojnë një mendim tjetër. Në ndërkohë ekzistojnë barrierat të cilat mund të tejkalohen së bashku me bashkëpunim nga institucionet, organizatat dhe qeveria.⁷³

Një tjetër punëtor social theksoi se për një "64-vjeçar dhe me mentalitet kosovar - shqiptar çështjet e të drejtave të transgjinnorëve janë abnormale dhe ne kemi probleme shumë më të mëdha të merremi me kësi lloj gjërash".⁷⁴ Megjithatë, një tjetër punëtor social është i mendimit që ky grup vazhdon të mbetet i cënueshëm. Është çështje e mentalitetit dhe fakti që kemi tranzicion ka ndodhur goxha shpejtë, por nuk ka ndodhur e njëjta me rastin e kësaj kategorie personash që nuk kanë ekzistuar për një kohë të gjatë. Për momentin ata mbesin të cënueshëm por sa më shumë që njerëzit vizitojnë vendet tjera me kohë gjërat me gjasë do të ndryshojnë.⁷⁵

Çështja e martesave në mes gjinisë së njëjtë duket të jetë lartë në agjendë sipas një tjetër punëtori social që deklaroi se kjo mund të jetë pjesë e kornizës juridike. Sidoqoftë, sa i perket tranzicionimit të një personi ai ishte i mendimit se kjo nuk është e mundur të bëhet në Kosovë për shkak të shpenzimeve. Megjithatë, ndërrimi i emrit është i mundur.⁷⁶

Siç është vërejtur korniza juridike mund të jetë një mundësues i rëndësishëm në avancimin e të drejtave të personave transgjinnorë. Punëtorët social si një prej bartësve të detyrave kanë rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve në pajtim me këtë kornizë. Përgjigjet me sa duket tregojnë se ekziston një vetëdije lidhur me ekzistencën e kornizës juridike por u dhanë informata të kufizuara lidhur me këtë. Ndalimi i diskriminimit është një prej parimeve kyqe, edhe pse nuk u përmend nga asnjëri prej tyre. Në anën tjetër martesë ishte diçka që u përmend, edhe pse nuk është relevante në këtë drejtim. Për më tepër, fakti që disa punëtorë socialë nuk i shohin personat transgjinnorë si të cënueshëm apo potencialisht të cënueshëm mund të jetë gjithashtu

71 Intervista 16

72 Intervista 4

73 Intervista 14

74 Intervista 1

75 Intervista 7

76 Intervista 8

problematike duke pasur para sysh mentalitetin në Kosovë dhe mungesën e njohurive në mesin e profesionistëve, familjeve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Përvoja në mbështetjen e personave transgjiorë

Një pjesë tjetër e intervistës është fokusuar në dokumentimin e përvojave në ofrimin e mbështetjes për personat transgjiorë, si dhe marrjen e një vështrimi nga profesionistët se sa janë ndjerë rehatshëm duke punuar në raste të tilla.

Rastet që kanë të bëjnë me mbështetjen e dhënë për personat transgjiorë janë të pakta. Kjo për shkak se vetëm një numër i vogël i punëtorëve socialë të intervistuar i referoheshin rasteve që kanë trajtuar. Arsyet për këtë nuk janë krejtësisht të qarta. Mungesa e ndërgjegjësimit dhe pranimin midis shoqërisë në përgjithësi mund të ndikojnë në personat transgjiorë që kërkojnë mbështetje. Në të njëjtën kohë mund të ketë hezitim nga personat transgjiorë për të kërkuar mbështetje të tillë në bazë të asaj se ata mund të paragjykojnë, ose që konfidencialiteti i tyre nuk do të ruhet.

Një rast që u përmend nga një punëtor social i referohet trajtimit të një të mituri që ishte dhunuar nga një i rritur. Përderisa mbështetja ishte ofruar asnjëra nga palët nuk ishte identifikuar si transeksual, kjo nuk është veçanërisht e rëndësishme për këtë raport. Megjithatë, duke shikuar kah e ardhmja punëtori social përmendi se qendra për punë sociale është në një pozitë më të mirë për të siguruar shërbimet pasi që kishte punësuar një psikolog sepse një boshllëk i aftësive profesionale kishte ekzistuar më parë. Pavarësisht mungesës së përvojës punëtori social deklaroi se "unë do të isha në gjendje për të ndihmuar një person transgjior që i nevojitet ndihmë dhe do të ndjehesha plotësisht rehat me këtë".⁷⁷

Kur u pyetën se çfarë shërbime mund të ofrohen për një person transgjior i cili do të kërkonte ndihmë, një punëtor social theksoi nevojën për një sërë masash që mund të merren për të rritur ndërgjegjësimin. Nëse rasti kishte të bënte me fëmijë, shkollimi do të ishte prioritet. Megjithatë, gjithashtu do të ishte e nevojshme të ofrohen informacione në lidhje me të drejtën e atij personi dhe që të tjerët nuk kanë të drejtë për ta paragjykuar.⁷⁸

Duket se ekziston një pranim i përgjithshëm në mesin e punëtorëve socialë se ata nuk do të refuzonin ofrimin e ndihmës për një individ transgjior. Kjo u deklarua mbi bazën se një individ i tillë është i njëjtë si çdo tjetër, kjo do të ishte preferenca e tyre dhe "unë absolutisht nuk i paragjykoj. Ashtu si i ndihmoj një delikuenti, është e njëjtë. Ose sikur që po i ndihmoj disa fëmijëve që kanë çrregullime në marrëdhënien familjare, për mu është njëjtë".⁷⁹

Ndërsa përgjigja mbetet që punonjësit socialë nuk kanë pasur ndonjë kërkesë për të ofruar mbështetje për donjë person transgjior, në rast se do të bëhej një kërkesë e tillë u theksua se Qendra për Punë Sociale do të mund të ndihmojë me strehim, ndihmë sociale, mbështetje morale etj,⁸⁰ Më tej kur u pyet se si mbahen të informuar në lidhje me personat transgjiorë, një punëtor social vuri në dukje se kjo bëhet përmes internetit, edhe pse ndonjë trajnim do të ishte i mirëpritur.⁸¹

77 Intervista 1

78 Intervista 7

79 Intervista 8

80 Intervista 13

81 Ibid

Një prej rasteve të pakta që u citua ishte kur një punëtor social shpjegoi rastin e ofrimit të mbështetjes së një individi të mitur. Në këtë rast fëmija ishte zhdukur për 48 orë dhe posa ishte gjetur kur punëtori social e kishte intervistuar ajo theksoi se ndihej më shumë mashkull sesa femër. Ajo gjithashtu kishte ndryshuar pamjen e saj disi brenda një kohe të shkurtër duke ngjyrosur flokët e saj dhe duke vendosur pirsing. Pas këtij incidenti, punëtori social kishte punuar me familjen për të siguruar që fëmija ka vazhduar me shkollimin e saj. Punëtori social kishte propozuar ndihmë mjekësore në mënyrë që seksi apo gjinia do të mund të përcaktoheshin. Pavarësisht punës me fëmijën për deri në 2 vjet e gjysmë, kur fëmija ka arritur moshën madhore, fëmija vendosi që trajtimi nuk ishte i nevojshëm pasi ajo nuk e konsideronte më ndryshimin e gjinisë.⁸²

Në një rast tjetër një punëtor social shpjegoi se një 13 vjeçar që ishte asistuar, vishte rroba vajzash, ndihej femër, donte ndryshimin e gjinisë në femër dhe ishte duke kërkuar për mundësitë që t'i nënshtrohet këtij operacioni të nevojshëm. Ishte shprehur se një nga arsyet është se kishte filluar të ketë dhimbje në stomak në baza mujore që ngjante në dhimbje menstruale. Megjithatë, punëtori social gjeti se djali përballej me një mjedis të vështirë - ai nuk ishte kuptuar, vullneti dhe dëshirat e tij nuk ishin respektuar, në mënyrë të veçantë babai i tij nuk tregonte fare mirëkuptim. Punëtori social kishte zhvilluar disa vizita në shtëpi dhe gjeti se nëna e tij e mbështeste dhe inkurajonte shumë, edhe pse kishte frikë, nëse babai i tij zbulon gjendjen e tij të vërtetë. Punëtori social vuri në dukje se një ambasadë ishte kontaktuar në lidhje me ndonjë mundësi mbështetjeje për ndërhyrje kirurgjike, por kjo ishte hedhur poshtë.⁸³

Në hulumtimin e pyetjes se sa komod ishte një punëtor social të ndihmonte një person transgjjinor, një punëtor social komentoi "ky është edhe detyrim ligjor edhe human, çdo person i cili kualifikohet për mbrojtje sociale ... ne jemi të detyruar me ligj për të ofruar mbështetje. Përndryshe privatisht, ajo që është humane, fetare, etike, është mirë për të ndihmuar të gjithë, pa shkelur të drejtat e askujt".⁸⁴ Është interesante pasiqë ofrohet një pasqyrë në një konflikt që një punëtor social mund të ketë më vete në lidhje me këtë çështje. Në të njëjtën kohë, ndoshta pasi që janë pyetur më parë në këtë temë, ata janë mësuar të përgjigjen në një mënyrë për të mos u dukur kontravers edhe nëse përgjigjet e tyre, po që se lexohen brenda rreshtave nuk janë në harmoni. Një tjetër punëtor social deklaroi se "nuk është e lehtë për të ndihmuar një rast të tillë ... por ne jemi të obliguar që të kjo do të thotë që ne nuk mund t'i shmangemi këshillimit, mbështetjes, apo duke siguruar sygjerimet që janë të nevojshme në dritën e asaj që ne e dimë. do të ishte e vështirë ... por refuzimi për t'u marrë me një rast nuk është opsion".⁸⁵

Hulumtimi tregon se punëtorët socialë kanë përvojë të kufizuar në ofrimin e mbështetjes. Disa nga rastet që iu referuan ose nuk kishin lidhje me çështjet e transgjjinorëve ose ndikimi i mbështetjes së ofruar nuk është i qartë. Në të njëjtën kohë kjo nuk lë të kuptohet se nuk ka individë që kërkojnë mbështetje dhe mbi këtë bazë. Qendrat për Punë Sociale duhet ta konsiderojnë këtë grup si një prej përfituesve dhe të sigurojnë që punëtorët socialë janë plotësisht të përgaditur. Në asnjë nga rastet e referuara nuk ishte ofruar ndihma e profesionistëve, që do të ishte e rëndësishme në veçanti për shkak se akoma vazhdon të ketë mungesë të kuptimit të personave transgjjinorë.

82 Intervista 18

83 Intervista 4

84 Intervista 15

85 Intervista 16

Trajtimi i çështjeve të transgjimore

Tabela 4

I intervistuari	Nëse juve personalisht do të ju kërkohet që t'i ofroni ndihmë një personi transgjimor (një të rrituri apo të mituri) sa rehatshëm do të ndiheshit prej 1 (jo komod / rehatshëm) deri 10 (absolutisht komod / rehatshëm)?									
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1										X
2								X		
3									X	
7										X
8										X
9					X					
13 ⁸⁶				X	X					
18							X	X		
15				X						
5								X		
6						X				
14										X
10							X			
11				X	X					
12										X

Gatishmëria e punëtorëve socialë siç tregohet nga tabela për t'u angazhuar është inkurajuese. Sidomos pasi që shumë prej tyre përmendën ndjenjën e tyre të detyrës, kur thirren për të ofruar asistencë. Megjithatë, një tjetër arsye se pse rezultatet janë të larta mund të pasqyrojë faktin se punëtorët socialë mund të jenë të fokusuar më shumë vetëm në standardet profesionale pa menduar për ndjenjat e tyre, që nuk është domosdoshmërisht gjithë ajo çka kërkon pyetja.

Të intervistuarit theksuan se nuk ka dokumente të politikave në nivel lokal apo ndonjë protokol pune dhe se nuk janë ofruar trajnime se si duhej trajtuar ky grup dhe disa punëtorë socialë sygjeruan se po ti kishin këto në dispozicion do të mund t'u ndihmonte të sigurohen që personat transgjimorë përkrahen në mënyrë të duhur. Për më tepër fokusimi i trajnimeve në aspekte psikologjike mund të ndihmojë në promovimin e mirëkuptimit, si dhe për t'u siguruar se ofrohet përkrahja e duhur.

Qasja në kujdes shëndetësor

Intervistat me profesionistët e kujdesit shëndetësor janë kryer duke përdorur pyetësorë të strukturuar. Rezultatet janë paraqitur duke u fokusuar në tema të ngjashme si: të dhënat në lidhje me të intervistuarit; njohuritë e tyre lidhur me çështjet trans si dhe përvoja e tyre në përkrahjen e personave transgjimorë.

⁸⁶ Bazuar në mungesën e përvojës dhe aftësive për të punuar me këtë grup

Tabela 5

Mosha	Gjinia	Përkatësia etnike	Institucioni
34	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Neurologji
35	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Kirurgji
47	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali Rajonal Prizren – Endokrinologji
50	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali Rajonal Prizren – Gjinekologji
50	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali Rajonal Gjakovë – Psikiatri
54	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali Rajonal Gjakovë – Psikiatri
44	Femër	Kosovar – Shqiptar	Spitali Rajonal Gjakovë – Gjinekologji
58	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali Rajonal Gjakovë – Gjinekologji
62	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Endokrinologji
34	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës –Instituti i Psikologjisë Forenzike
47	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Urologji
50	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës - Gjinekologji
56	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra e Shëndetit Mendor në Bashkësi – Prizren (Psikiatër)
56	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali i Përgjithshëm – Prizren (Urolog)
62	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali i Prizrenit – Departamenti i Gjinekologjisë (Gjinekolog)
39	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës (Endocrinolog)
46	Femër	Kosovar – Shqiptar	Qendra Klinike Universitare e Kosovës (Endocrinolog)
37	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	University Clinical Centre of Kosovo - Psikiatri (Psikiatër)
44	Femër	Kosovar – Shqiptar	Klinika e Psikiatrisë (Psikolog)
50	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali i përgjithshëm – Ferizaj (Gjinekolog)
44	Femër	Kosovar – Shqiptar	Spitali i përgjithshëm – Ferizaj (Endocrinolog)
40	Mashkull	Kosovar – Shqiptar	Spitali Rajonal Ferizaj (Urolog)

Ngjashëm me punëtorët socialë, mosha e profesionistëve shëndetësorë dominohet nga kategoria 40+. Kjo është e rëndësishme dhe domethënëse për shkak se ata me gjasë kanë kryer shkollimin shumë më herët dhe gjasat janë të vogla që të kenë informata të përditësuara me zhvillimet që kanë ndodhur lidhur me personat transgjnorë. Siç është vënë në dukje ka pasur përparime shkencore sa i përket përshkrimeve lidhur me intervenimin kirurgjik për ndërrimin e gjinisë dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme për një shoqëri që ka pasur ekspozim të kufizuar dhe aktualisht nuk kanë kushte të pranimit.

Të kuptuarit e çështjeve të transgjiorëve

Table 6

Intervista	Transgjior	Transvestit	Trans-seksual
01	"Nuk e di"	"Nuk e di"	"Ndërrimi i gjinisë"
02	"Transportimi i gjinisë ose bartje gjinore, prej një organizmi në organizëm tjetër"	"Çrregullimet e epsheve ose kryerja e aktit në mënyrë jo adekuate.; lodra seksuale – plastike. Por është Ok, ka të drejtë."	"-Kombinim i A dhe B."
03	"Nuk e di"	"Personat e një gjinie të caktuar vishen me rroba të gjinisë së kundërt "	"Nuk e di"
04	"Marrëdhënie me dy gjinitë"	"Nuk e di"	"Nuk e di"
05	"... individi që dëshiron ta ndërroj gjininë, qoftë mashkullore në femrore, ose e kundërta."	"Është psiko-patologji, një fenomen ku meshkujt imitojnë femrat, pra marrin teshat e femrave p.sh ndonjë breg, jelek apo ndonjë send tjetër."	"... kur individi mashkull e pëlqen gjininë femrore, mirëpo edhe i kushton kujdes të madh veshjes, apo mënyrës se si sillet ndaj gjinisë së kundërt."
06	"Ndërrimi i gjinisë përmes ndërhyrjeve operative e hormonale"	"kur personi edhe pse fizikisht i takon njërës gjini sjelljet, paraqitja veshja e bën të gjinisë së kundërt"	"Fizikisht, psikikisht dhe në aspektin hormonal i takon të dy gjinive"
07	"Kur është me gjini femër ose mashkull dhe kërkon të transferohet në gjini tjetër"	"Nuk e di"	"Nuk e di"
08	"Ndërrim i seksit"	"Nuk e di"	"Pëlqimi i seksit të njëjtë"
09	"Person që bart dy gjinitë psikikisht edhe pse e ka njërën fizikisht"	"Tiparet e jashtme, veshja"	"Nuk e di"

10	"Gjinia e tyre është e kundërt nga seksi që posedojnë"	"Persona që vishen me rroba të gjinisë së kundërt"	"Ndërrimi i seksit përmes intervenimeve kurorgjike"
11.	"Mendoj se transgjinator, transvestit dhe transeksual është i njejti sen, dhe nënkupton mosdefinimin e qartë të gjinisë së tij/saj"		
12	"Nuk e di"	"Nuk e di"	"Nuk e di"
17	"Trans, mes dy gjinive"	"Përpara ka qenë çrregullim i seksualitetit, Tash nuk merret si çrregullim. Është ni shprehi, ni mënyrë e jetesës"	"Qysh thash ma parë. Mes dy gjinive"
18	"Personi i cili ka elemente të dy gjinive"	"Nuk e di këtë term"	"Unë mendoj e njëjta gjë transgjinator, transeksual. Nuk di ndryshe "
19	"Devijim mendor"	"S'kam dëgju"	"Qita de, qita pederat"
16	"Transgjinator domethënë njeriu që nuk i takon as gjinisë femërore e as gjinisë mashkullore"	"Nuk kam informatë"	"Mendoj që kjo si e para"
20	"As femër, as mashkull"	"Me zë mashkulli, me tipare të femrave"	"Ndërrimi i seksit"
21	"Me ndryshu gjininë"	"Nuk e di"	"Me ndryshu gjininë edhe kjo"
22	"Persona që dëshirojnë me ndërru gjininë"	"Persona që kanë kry intervenim"	"Pak a shumë janë të njëjta"
23	"Persona të cilët mundën me pas pëlqim për gjininë tjetër apo...."	"Persona që dëshirojnë me veshë rroba të gjinisë tjetër, t'kundërt "	"Që pëlqejnë gjininë e njëjtë"
24	"...është kur seksi femën transformohet në mashkull ose seksi mashkull në femën me operacione"	" E kom ndëgju po tash a s'osht e njëjtë a? Transvestit është kur je femën po sillesh si mashkull."	" Tash s'po di bash kështu me formulë. A po kupton?"
25	"Biseksor"	"Me çrregullime t'marrëdhënies, të dëshirës "	"Qita s'pe kuptoj bash"

Rezultatet e kësaj pjese të hulumtimit tregojnë llojllojshmëri të përgjigjeve nga profesionistët shëndetësor kur pyeten për të bërë dallimin në mes këtyre termave. Përgjigja më e zakonshme ishte "Nuk e di", e cila ishte përdorur 14 herë nga 25 përgjigje. Gjithashtu në të shumtën e rasteve, të intervistuarit përkundër mungesës së njohurive apo kuptimit të dallimit në terminologji mundoheshin të jenë respektues ndaj pjesëtarëve të komunitetit transgjnorë. Megjithatë, është shqetësuese që në disa raste, të intervistuarit treguan pakënaqësinë e tyre, e cila ishte shprehur në formën më ekstreme nga një i intervistuar që i emëronte pjesëtarët e komunitetit transgjnorë duke përdorur terme poshtëruese si "qita pederat".

Një çështje tjetër që duhet adresuar ishte se disa nga të intervistuarit, përkundër faktit se janë një nga adresat ku pjesëtarët e komunitetit transgjnorë do të duhej të kërkonin ndihmë ose asistencë, ata akoma i shohin personat transgjnorë si individë me çrregullime mendore.

Terminologjia: seksi apo gjinia

Një pyetje tjetër e rëndësishme që u shtrua ishte bazuar në terminologjinë lidhur me seksin dhe gjininë dhe cilat janë dallimet në mes të këtyre dyjave.

Tabela 7

Intervista	Gjnia	Seksi
01	"Ka të bëjë me organin gjenital"	"Ka të bëjë me orientimin seksual"
02	"Mashkull ose femër"	"Njësoj si A"
03	"Karakteristikat e personit të përcaktuara me gjenetikë"	"Karakteristika e personit varet nga tërheqja seksuale, nga gjinia e njëjtë ose e kundërt"
04	"Gjinia është mashkull ose femër"	"Marrëdhënie seksuale mashkull-femër"
05	"Gjinia është përkatësi e çdo individi, qoftë gjinia mashkullore, femërore ose transvestite"	"Interesimi i individit në seksin mashkullor ose femëror. Një cilësi apo veti e një individi që është përcaktuar për llojin e seksit "
06	"Mashkull ose femër"	"Aktin seksual"
07	"Gjinia është determinimi i seksit. Mashkull ose femër"	"Gjini dhe seks afërsisht të njëjtë"
08	"Përkatësia seksuale"	"Raportet/Marrëdhëniet mes dy gjinive të kundërta"
09	"Përkufizohet në lindje, mashkull ose femër"	"Ka të bëjë me seksualitetin, zhvillohet, ndryshon"
10	"Në aspektin e ndjesisë"	"Aspekti biologjik, si e ka kriju natyra"
11	"Mashkull ose femër"	"Seksi është njësoj si gjinia"
12	"Prezenca e organeve gjenitale përcakton gjininë"	"Seksi ka të bëjë më marrëdhëniet seksuale"

17	"Aq thjeshtë sa s'po di qa me thanë. Kalojmë, tjetrën!"	"Seksi, gjinia"
18	"Karakteristikat e një personi që e dallojnë a është mashkull apo femër"	"Nëse kuptohet si akt, domethanë marrëdhënie mes dy personave, mes dy gjinive. Por unë e kuptoj edhe gjini me të njëjtin emër. Gjini, seks sinonim i njëri tjetrit"
19	"Po seksi de, gjinia. Mashkull ose femër"	"Po njëjtë, seks, gjini."
16	"... kuptoj njeriu që i takon, ose gjinisë femërore ose gjinisë mashkullore, në aspektin e dukjes, sjelljes edhe orientimit seksual"	"Seksi mendoj lidhet me të njëjtat... me orientim seksual."
20	"Mashkull ose femër"	"Femër ose mashkull"
21	"Orientimi gjinor"	"Biologjia"
22	"Mënyra qysh sillemi"	"N'këtë rast është lindja, qysh kam lindë, ndërsa gjinia është qysh unë dëshiroj mu sill, me sjellje"
23	"Përcaktimi i gjinisë domethanë, mashkull apo femër"	"Ni raport mes dy personave"
24	"Gjinia është ajo që përcakton seksin mashkull apo femër"	"Gati e njëjta është, seks fëmëror, seks mashkullor"
25	"Raporti i organeve gjenitale që i përket"	"Gjini, përkatësia e organeve"

Dallimet në mes seksit dhe gjinisë u theksuan drejtë vetëm nga një numër i kufizuar i të intervistuarve. Ashtu si me punëtorët socialë edhe te profesionistët shëndetësorë u shkaktua huti me përdorimin e dy termave, veçërisht për shkak të faktit se zakonisht nuk përdoren të dy termat në gjuhën shqipe.

Ndërhyrja kirurgjike për ndryshimin e gjinisë dhe trajtimet tjera

Një profesionist shëndetësor vuri në dukje në lidhje me individët që duan t'i nënshtrohen operacionit të ndryshimit të gjinisë se "ata duhet të respektohen, por vetëm nëse ka bazë për këtë, në terma anatomikë dhe psikologjikë".⁸⁷ Një tjetër profesionist u pajtua se kjo duhet të jetë në dispozicion, edhe pse pranoi se nuk ka një strukturë për të bërë këtë dhe për individët që kërkojnë këtë trajtim duhet të udhëtojnë jashtë vendit.⁸⁸ Gjithashtu u theksua se në aspekt mjekësor kjo është e mundur, edhe pse kushtet në Kosovë janë të tilla që nuk do të ishte e mundur për të bërë këtë.⁸⁹

Ndërhyrja kirurgjike për ndryshimin e gjinisë do të duhej të ishte në dispozicion deklaroi një tjetër profesionist shëndetësor. Megjithatë, një sygjërim shtesë ishte se për shkak të natyrës së saj të përhershme duhet të jetë kriter konsultimi me psikologë dhe psikiatra paraprakisht.⁹⁰

87 Intervista 18

88 Intervista 21

89 Intervista 23

90 Intervista 3

Megjithatë, kjo nuk ishte pikëpamje unanime, një tjetër profesionist në përgjigje të pyetjes nëse personat transgjiorë duhet të kenë qasje në ndërhyrje kirurgjike për ndryshimin e gjinisë ishte përgjigjur "jo, aspak kjo është një devijim mendor". Profesionisti i njëjtë vazhdoi duke thënë "shoqëria jonë nuk e pranon këtë".⁹¹ Ky mendim ndahej edhe nga një tjetër i cili tha se "personalisht unë mendoj se jo" lidhur me atë se a do të duhej të jetë e mundur që personat transgjiorë t'i nënshtrohen ndërhyrjes kirurgjike për ndryshimin e gjinisë.⁹² Poashtu një tjetër profesionist thjeshtë deklaroi se përgjigja duhet të jetë "jo" pa dhënë ndonjë shpjegim shtesë.⁹³ Për një tjetër të intervistuar, kjo është një çështje që duhet të zgjidhet me ligj dhe mendimi i tij është se "çdo gjë që është kundër natyrës është një humbje kohe dhe unë nuk do ta propozoja" një trajtim të tillë.⁹⁴

Në të njëjtën kohë është inkurajuese se shumica e profesionistëve shëndetësorë të intervistuar mendojnë se operacioni për ndryshimin e gjinisë duhet të ofrohet për personat transgjiorë, nëse ata kërkojnë. Një nga të intervistuarit deklaroi se "çdo gjë që ata kërkojnë duhet të ofrohet, për aq kohë sa ajo nuk e dëmton shëndetin e tyre".⁹⁵ Megjithatë ka ende individë të cilët ushtrojnë këtë profesion, por nuk pajtohen se ajo është brenda fushëveprimit të tyre të detyrimeve dhe e konsiderojnë këtë një çështje të natyrës, jo të njerëzve, ose siç tha një nga të intervistuarit "Duhet të vendoset me ligj Çdo gjë që është kundër natyrës, është e kotë, unë nuk do ta rekomandoja".⁹⁶ Ndër mjekët që janë intervistuar gjatë këtij hulumtimi disa prej tyre shprehën mendimin e tyre kundërshtues ndaj ndryshimit të gjinisë duke deklaruar se "Zoti ka vendosur mashkull ose femër. Unë nuk do të mbështesja edhe në qoftë se fëmijët e mi do të jenë anëtarë të komunitetit LGBTI. Është abnormale"⁹⁷ ose "jo, assesi jo. Ky është një devijim mendor".⁹⁸

Përkundër faktit se shumica prej tyre pajtohen se ndryshimi i gjinisë duhet të ofrohet si një mundësi për personat transgjiorë të cilët e kërkojnë këtë, kur u pyetën nëse kjo mund të bëhet në Kosovë, përgjigjet janë shumë kontradiktore. Disa nga mjekët mendojnë se kjo mund të bëhet, disa prej tyre nuk janë në dijeni se kjo mund të bëhet, ndërsa grupi i tretë i mjekëve thonë se nuk është e mundur. Njëri prej tyre, shpjegoi se "Ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë ndryshimin e gjinisë për momentin. Për shkak se këto procedura kërkojnë trajtim të veçantë".⁹⁹

Përderisa të intervistuarit ofrojnë një gamë të gjerë të përgjigjeve, zhvillimet e fundit shkencore nuk mund të shihen në këto përgjigje. Shumica pranojnë se procedurat e tilla nuk janë në dispozicion në Kosovë. Megjithatë, ata nuk vazhdojnë të tregojnë arsyet se pse apo nëse procedurat e tilla duhet të jenë në dispozicion. Një pakicë e të intervistuarve duket se sygjeron se të gjitha duhet të ofrohen në përputhje me ligjin. Megjithatë, disa nga këta të intervistuar kualifikojnë këtë përgjigje duke sygjieruar se trajtimi duhet të jetë në dispozicion me kusht që kjo nuk shkon kundër natyrës. Të tjerë të intervistuar konsiderojnë se mund të procedohet me trajtim vetëm pasi të jetë konsultuar psikologu dhe psikiatri. Një formë e konsultimit mund të jetë e nevojshme për shkak të përhershmërisë së çfarëdo intervenimi kirurgjik, megjithatë, në qoftë se kjo çështje konsiderohet vetëm nga perspektiva e shëndetit mendor, atëherë kjo ngritë çështje të tjera.

91 Intervista 19

92 Intervista 16

93 Intervista 4

94 Intervista 8

95 Intervista 1

96 Intervista 8

97 Intervista 4

98 Intervista 19

99 Intervista 2

Në tërësi, nga profesionistët shëndetësor është e pritshme të merren përgjigje më të hollësishme, gjë që nuk ndodhi në këtë hulumtim. Për disa prej tyre kjo mund të jetë për shkak të mungesës së njohurive, por gjithashtu edhe për shkak të mungesës së pranimit përderisa disa të tjerë nuk i kanë të qarta këto zhvillime. Duke shikuar kah e ardhmja, duhet të jetë prioritet ngritja e vetëdijes lidhur me zhvillimet e fundit lidhur me hulumtimet dhe trajtimet shkencore si dhe mbështetja që duhet ofruar pacientëve.

Roli i profesionistëve shëndetësorë

Roli i profesionistëve shëndetësor në ofrimin e mbështetjes për personat transgjiorë nuk është ai që pranohet lehtë nga të gjithë. Një i intervistuar nuk ishte i sigurt për pozicionin e tyre e duke thënë "Unë nuk jam i sigurtndoshta kanë".¹⁰⁰ Të tjerët duket se refuzojnë që punëtorët e shëndetësisë kanë ndonjë rol". "Aspak. Kush do të mbështesë ata ... njerëz abnormalë".¹⁰¹ Pa dhënë ndonjë arsye specifike një tjetër i intervistuar gjithashtu u përgjigj negativisht në lidhje me rolin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor.¹⁰² Në mënyrë të ngjashme, një tjetër i intervistuar deklaroi se "nuk kemi nevojë me i mbështet, ne i injorojmë ata, sepse ata janë njerëz të ultë, ata janë për psikiatri."¹⁰³

Për disa profesionistë shëndetësorë mund të mos jetë në kuadër të ekspertizës së tyre ose për shkak të mungesës së aftësisë për ofruar mbështetjen e nevojshme. Një i intervistuar theksoi "normalisht po, ata (mjekët) duhet të kenë rol ... por në profesionin tim, unë nuk kam pasur kërkesa të tilla dhe unë për veti nuk di mu marr me kit punë".¹⁰⁴

Megjithatë një grup i profesionistëve pranuan se profesionistët e kujdesit shëndetësor kanë rol duke thënë se ka të bëjë me mbështetjen e tyre në vështirësitë që jeta sjell ashtu si për të gjithë njerëzit e tjerë.¹⁰⁵ Një profesionist shëndetësor vuri në dukje se "sigurisht ka ... nëse ata kërkojnë ndihmë nga ne ose para një ndërhyrje ose në lidhje me një situatë kur nuk ndjehen mirë".¹⁰⁶ Një pikëpamje tjetër është se roli i mjekëve në lidhje me personat transgjiorë është i pashmangshëm sidomos kur kërkohen trajtimet. Ky mendim ndahet edhe nga një i intervistuar i cili thekson se profesionistët e kujdesit shëndetësor kanë një rol që nga diagnostifikimi e deri tek faza apo trajtimi post-operativ.¹⁰⁷

Profesionistët shëndetësor mund të kenë një rol të rëndësishëm në sigurimin e mbështetjes dhe udhëzimeve për personat transgjiorë, gjatë fazave të ndryshme kur janë duke konsideruar një trajtim të tillë si terapi hormonale, ndërhyrje kirurgjike ose janë në kërkim të këshillimit. Fakti se një numër i madh i të intervistuarve nuk vijnë në përfundim se ata kanë një rol në sigurimin e një mbështetjeje të tillë është shqetësuese. Kjo jo vetëm që tregon një mungesë të vetëdijes për çështjet me të cilat përballen personat transgjiorë, por edhe mungesa e njohurive lidhur me zhvillimet e fundit në këtë fushë të trajtimit. Një pjesë e vogël që e pranojnë se ata kanë një rol që mund të jetë ekstenziv përgjatë gjithë procesit mund të jetë një grup i rëndësishëm për të punuar me ta, me qëllim të senzibilizimit dhe për të ngritur standardet në mesin e profesionistëve shëndetësorë të tjerë.

101 Intervista 18

101 Intervista 19

102 Intervista 16

103 Intervista 4

104 Intervista 20

105 Intervista 21

106 Intervista 22

107 Intervista 5

Mbrojtja juridike

Pasi që në kohët e fundit çështja e të drejtave të personave LGBTI është bërë më e zakonshme, ajo është duke u vënë re nga pjesë të ndryshme të shoqërisë. Një i intervistuar vuri në dukje "... pllakata që ishin shënu gjatë verës, liri për gej, liri për lezbike. M'pëlqyen. Dhe mjaft të mbështetur prej shtetit".¹⁰⁸

Një tjetër i intervistuar theksoi "Unë nuk e di nëse ka një ligj, por ne jemi paragjykues ... sigurisht që duhet të ketë"¹⁰⁹ legjislacion që mbron të drejtat e tyre. Në të njëjtën kohë ky profesionist e pranoi se ka një detyrim ligjor në lidhje me atë se si trajtohen pacientët dhe deklaroi se "mbi të gjitha është zgjedhja e individit ... që do të trajtohen në mënyrë të barabartë ... duhet të marrim parasysh kërkesat e tyre dhe ti dëgjojmë ..."¹¹⁰ Poashtu një tjetër i intervistuar theksoi se ai nuk është në dijeni për detajet, por e di se institucionet shtetërore janë duke punuar në drejtim të barazisë gjinore.¹¹¹

Megjithatë, një tjetër i intervistuar duke u përgjigjur në pyetjen se a ka ndonjë detyrim ligjor në lidhje me atë se si profesionistët shëndetësorë i trajtojnë personat transgjnorë tha: "Unë nuk mendoj se ne kemi ndonjë detyrim ligjor..."¹¹²

Megjithëse informacionet lidhur me standardet ligjore ishin të pakëta në mesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, ka pasur disa të cilët ishin të informuar mirë. Njëri u përgjigj "Unë mendoj se korniza ligjore është e konsoliduar mirë, ku edhe Kushtetuta parashikon të drejtat e tyre dhe unë mendoj se kjo duhet zbatuar sepse ata kanë nevojë për mbështetje."¹¹³ Në mënyrë të ngjashme, përgjigja e një tjetri ishte se "Unë mendoj se Kushtetuta e lejon këtë, por opinioni publik nuk është gati për të pranuar këta njerëz. Kuadri ligjor ekziston, por zbatimi në praktikë nuk është i mjaftueshëm."¹¹⁴

Përgjigjet e profesionistëve shëndetësorë në këtë çështje janë të ngjashme me ato në pyetjet paraprake dhe janë dhënë një numër i përgjigjeve të ndryshme. Dy çështje që mund të identifikohen si shqetësuese janë se një numër i kufizuar i profesionistëve pranojnë se korniza juridike duhet t'i mbrojë personat transgjnorë, përderisa një grup tjetër beson se nuk kanë ndonjë detyrim për të ofruar trajtim. Qartazi, këtu do të duhej të ishte fokusi në mos-diskriminim, edhe pse kjo nuk u përmend nga ta si çështje. Megjithatë, me anë të diskutimit në focus-grup, respondentët identifikuan paragjykimet dhe diskriminimin si çështje që i shqetëson në rastet kur kërkojnë shërbime. Mbi këtë bazë, ngritja e vetëdijes dhe senzibilizimi janë të nevojshme jo vetëm për të drejtat e personave transgjnorë, por duke u fokusuar në ato fusha kur profesionistët shëndetësorë kanë nevojë që të tregojnë kujdes më të madh dhe se ata janë përgjegjës për të siguruar se nuk i shkelin të drejtat e personave transgjnorë.

108 Intervista 17

109 Intervista 20

110 Ibid

111 Intervista 3

112 Intervista 16

113 Intervista 22

114 Intervista 22

Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor për personat transgjnorë

Një psikiatër vuri në dukje se është e rëndësishme për të zbatuar një qasje multidisiplinare, me rastin e trajtimit të personave transgjnorë. Të identifikohen organizatat ku mund të bëhen referime për shërbime që shihen si të rëndësishme, edhe pse organizata të tilla nuk janë gjithmonë të dukshme. Trajnimet, gjithashtu, llogariten si një aspekt i rëndësishëm. Pavarësisht nga përvojat e kufizuara të trajtimit të personave transgjnorë ka pasur raste për shembull kur “një mashkull i cili donte të bëhej femër dhe erdhi për këshillim dhe për të marrë një opinion. E kam mbështetur fillimisht, por më vonë ai nuk u duk më. Nuk di çka ka ndodhë më tej”.¹¹⁵ Rëndësia e punës multidisiplinare është identifikuar edhe nga një tjetër profesionist i cili vuri në dukje se ajo mund të jetë e dobishme që të ketë bashkëpunim ndër-institucional¹¹⁶, si për shembull një psikiatër mund të ketë nevojë për të bashkëpunuar me një punëtor social apo një shkollë.

Gjithashtu mund të identifikohet si qëndrim i zakonshëm që individët transgjnorë mund të kërkojnë shërbime të kujdesit shëndetësor si çdo pacient tjetër pa iu referuar identitetit të tyre gjinor dhe është e rëndësishme që në raste të tilla pacienti dhe zgjedhjet e tyre të respektohen. Një profesionist vuri në theks se një pacient transgjnor ishte trajtuar për abuzim substancash, edhe pse çështjet lidhur me identitetin gjinor nuk ishin ngritur si shqetësim, profesionist tha se “ne nuk na lejohet të ndërhyjmë”.¹¹⁷

Megjithatë disa raste mund të jenë më të ndërlikuara. Një i intervistuar theksoi se kishte trajtuar një person që kishte tentuar vetëvrasjen për shkak të mungesës së mbështetjes nga familja dhe rrethi në lidhje me vendimin e marrë. Gjatë kohës kur ky pacient ishte në nevojë, i ishte ofruar mbështetje.¹¹⁸

Ka edhe profesionistë tjerë që janë përballur në punën e tyre me persona transgjnorë. Një i intervistuar pohonte se një person transgjnor do të trajtohej sikur çdo pacient tjetër, edhe pse ai gjithashtu theksoi që do të ishte detyrë e profesionistit të trajtojë çdo problem të ngritur. Diskutimi shtesë në këtë pikë tregoi se ky profesionist mendonte se nderhyrja kirurgjike për ndryshimin e gjinisë nuk është fare çështje mjekësore. Kjo është e rëndësishme për tu identifikuar pasi që kjo kategori do të duhej të shënjestërohet si grup që ka nevojë për informata të përditësuara mbi zhvillimet e fundit dhe rolin që ata kanë në përmirësimin e qasjes dhe standardit të kujdesit.¹¹⁹

Për një tjetër të intervistuar çështja e punës multidisiplinare ose ofrimit të qasjes në përgjithësi për personat transgjnorë u hodh poshtë tërësisht duke thënë “duhet mi lanë ata...I konsideroj si t’smut...askush nuk duhet të merret me ta”. Për më tepër, nëse një person transgjnor do të kërkonte trajtim, përgjigja ishte se i do të kërkonte që të largohen “Unë nuk do të merrem me ta”.¹²⁰

Një tjetër çështje që u trajtua nga hulumtimi ishte të përcaktohet se çfarë ndërhyrje kirurgjike ose trajtimi hormonal është në dispozicion në Kosovë. Një i anketuar tha se “aq sa unë jam në dijeni në institucionet publike nuk kryhet një ndërhyrje e tillë. Për disa që kam dëgjuar apo lexuar janë kryer jashtë vendit. Sa i përket trajtimeve hormonale unë mendoj se mund të bëhen ...”.¹²¹

115 Intervista 17

116 Intervista 22

117 Intervista 21

118 Intervista 22

119 Intervista 18

120 Ibid

121 Intervista 22

Një nga hapat e parë që një pacient mund të ndërmarrë në këtë drejtim është të marrë sa më shumë informata. Megjithatë, siç vuri në dukje një i intervistuar pacientët kanë tendencë të jenë të përgatitur mjaft mirë duke bërë hulumtimet e tyre paraprakisht në mënyrë që të jenë më pjesëmarrës me rastin e trajtimit “dhe nganjëherë kanë informata më shume se une” dhe kjo ka ndodhur në 2 raste.¹²² Në mënyrë të ngjashme, një tjetër profesionist theksoi se “Unë nuk jam në dijeni se ndonjë trajtim i tillë është në dispozicion në Kosovë për momentin”.¹²³ Ky mendim ndahej edhe nga një tjetër i intervistuar, i cili pohoi se nuk mendon që ndërrimi i gjinisë është i mundur në Kosovë sepse “nuk ka përgaditje profesionale dhe mjete adekuate për kryerjen e ndërhyrjeve të tilla”.¹²⁴ Megjithatë trajtimi hormonal me sa duket është i mundur dhe një i intervistuar sygjeroi se me gjasë kjo mund të bëhet vetëm në Prishtinë.¹²⁵

Në mesin e një numri të vogël ka gjithashtu profesionistë që pohojnë se do të refuzonin të ofrojnë shërbime për personat transgjnorë. Për shembull, një i intervistuar kur u pyet se si do të reagoje nëse një person transgjnor do ta vizitonte për këshillim. Përgjigja e tij ishte “I them the qafën, dil jashtë.”¹²⁶

Përderisa kishte përgjigje pozitive, si ajo për përdorimin e punës multi-disiplinore dhe për të siguruar që shërbimet ofrohen pa diskriminim, ka edhe përgjigjet që ngrisin shqetësime. Moshgatishtëria e disa profesionistëve shëndetësorë për të ofruar shërbime shëndetësore është një nga këto. Ndërsa është e rëndësishme që profesionistët shëndetësorë nuk fshehin qëndrimet e tyre dhe shpjegojnë ndjenjat e tyre të vërteta, ajo që është më e rëndësishme se kjo çështje duhet trajtuar në mënyrë aktive për të përmirësuar qasjen në shërbime. Mungesa e eksperiencës mund të ndikojë në qasjen dhe në këtë drejtim trajnime me profesionistët shëndetësorë mund të jenë të nevojshme.

Trajnimet e tilla do të mund të pranoheshin më mirë sidomos nëse organizohen me qëllim të ofrimit të informatave të fundit dhe gjithashtu është e rëndësishme që organizimi të bëhet në bashkëpunim me profesionistët shëndetësorë, veçanërisht me ata që i shohin këto trajnime si të nevojshme dhe/ose kanë pasur përvoja në ofrimin e shërbimeve për personat transgjnorë.

122 Ibid

123 Intervista 23

124 Intervista 25

125 Intervista 5

126 Intervista 4

Takimi me pacientin për të diskutuar tranzicionimin

Tabela 8

Interview	Opcioni a: Menjëherë do ta referoja te psikiatri pasi që kjo është e qartë që është vetëm çështje e shëndetit mendor.	Opcioni b: Do ta refuzoja të takoj pacientin pasi që kjo nuk është çështje mjeksore me të cilën unë duhet të merrem	Opcioni c: Do ta takoja pacientin për të diskutuar rreth çështjes dhe të shohim se si unë dhe mundësisht profesionistët e tjerë mjekësorë do të mund të ndihmojmë.
1			X
2			X
3			X
4		X	
5			X
6			X
7			X
8	X		
9			X
10			X
11			X
12			X
17			X
18		X	
19		X	
16			X
20			X
21			X
22			X
23			X
24			X
25			X

Ngjashëm edhe me rezultatet e hulumtimeve me profesionistët e kujdesit shëndetësor në vende të tjera edhe te ne ka mendime të ndryshme të shprehura në lidhje me personat transgjisorë. Për profesionistët mjekësorë kjo është shqetësuese për shkak se pavarësisht nga pikëpamjet e tyre apo besimet në çështje të caktuara, mund të thuhet se është detyrim i tyre të ofrojnë asistencën. Në përgjithësi, përderisa shumica pohonin se do ta pranonin një pacient transgjisor, shqetësimet mbesin se ka akoma mjekë të ardhshëm që nuk janë mëndjehapur apo paragjykojnë situatën atëherë kur kontributi i tyre është më se i nevojshëm dhe njëkohësisht mund të shkelin standartet e tyre etike dhe detyrimet ligjore gjithashtu.

Trajnimi dhe informimi

Përgjatë intervistave profesionistët shëndetësorë janë pyetur edhe nëse ata do të ishin të interesuar në ndjekjen e ndonjë trajnimi në lidhje me çështjet transgjinore dhe nëse kishin njohuri për të gjitha standardet që lidhen me trajtimin e personave transgjinorë. Për disa kjo nuk ishte një temë me interes qoftë në aspektin e trajnimit apo standardeve "Unë nuk kam dëgjuar, unë nuk jam i interesuar, është një turp për të humbur kohë për këtë".¹²⁷ Në mënyrë të ngjashme, një tjetër i intervistuar tha "jo unë nuk e di dhe unë nuk dua të di. Unë nuk dua të ketë asgjë që ka të bëjë me ta."¹²⁸

Megjithatë në bilanc, shumica thanë se do të ishin të interesuar në ndjekjen e një trajnimi të tillë dhe se nuk ishin në dijeni të standardeve përkatëse, por u shpreh interesim për të marrur më shumë informata. Kjo është gjë pozitive, sepse në qoftë se ka vullnet për t'u angazhuar mund të ketë mundësi për të përmirësuar standardet e kujdesit në të ardhmen. Në mënyrë të ngjashme, pasi që disa po ashtu u pajtuan se puna multi-disciplinare do të mund të ishte e dobishme, kjo është gjithashtu e rëndësishme për tu siguruar që profesionistët e ndryshme të punojnë së bashku dhe të kenë bashkëpunim me organizatat që punojnë në senzibilizimin e opinionit dhe ofrojnë mbështetje për personat transgjinorë.

¹²⁷ Intervista 19

¹²⁸ Intervista 4

PËRFUNDIM

Në përfundim ky raport me fokus të veçantë në personat transgjnorë sjell një pasqyrë të rëndësishme në lidhje me kornizën juridike, pikëpamjet e disa personave transgjnorë dhe të dhëna që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale dhe qasjen në kujdesin shëndetësor. Në vitet e fundit është vërejtur një prani më e madhe e çështjeve lidhur me komunitetin LGBTI në Kosovë dhe kjo ishte e dukshme përgjatë këtij hulumtimi në disa nga përgjigjet që u ofruan. Përpjekjet e tilla duhet të vazhdojnë për tu siguruar që ka vetëdije më të ngritur në mesin e popullatës së përgjithshme dhe bartësve të përgjegjësive.

Korniza juridike ka elemente që njohin se identiteti gjinor duhet mbrojtur. Kjo ka potencial të kontribojë tutje në shumë sektorë ku mund të shfaqet diskriminimi kundrejtë personave transgjnorë. Në të njëjtën kohë korniza kombëtare mbetet mbrapa asaj që është zhvilluar në nivel evropian, në veçanti në ofrimin e garancive se të drejtat mund të realizohen me lehtësi. Një shembull për këtë është që procesi përmes të cilit një individ mund të kalojë në procedurat e tranzicionimit për ndërrimin e gjinisë tek ne ende nuk ekziston. Pasi që kjo mund të ketë ndikim fundamental në jetën e një personi në zhvillimin e jetës së përgjithshme, ndikimi mund të jetë tepër i madh në jetën private dhe dinjitetin e individit. Mbi këtë bazë kjo çështje do të duhej të adresohet me prioritet.

Pjesëtarët e komunitetit transgjnorë tregojnë se mungesa e të kuptuarit të identitetit të tyre gjinor në mesin e familjeve të tyre dhe shoqërisë në përgjithësi mund të ketë ndikime drastike në mundësitë e tyre për të zhvilluar një jetë normale. Disa nga të intervistuarit ndanë përvojat e vështira e potencialisht tragjike që mund të hasen si pasoje e mos-pranimit që madje në një rast quan në tentim vetëvrasjeje. Puna me punëtorët socialë është një komponentë tjetër e rëndësishme ku janë shprehur një varg pikëpamjesh mbi këtë temë. Jo të gjithë punëtorët socialë kanë njohuri të qarta për çështjet themelore por duke marrë parasysh mungesën e përvojës me persona transgjnorë kjo disi është e kuptueshme. Në tërësi ata duken të jenë mendjehapur dhe treguan përkushtim në ofrimin e shërbimeve për të gjithë ata të cilët përmbushin kushtet për pranimin e ndihmës. Megjithatë, ka boshllëqe që duhet plotësuar e që mund të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve për personat transgjnorë. Qendrat për Punë Sociale do të duhej të mbikqyrnin gjendjen lidhur me personat transgjnorë, t'i identifikojnë ata si grup përfitues dhe t'i përfshijnë në çdo dokument planifikues. Vetëm përmes planifikimit efektiv dhe angazhimit mund të ndërtohet mirëbesim në menyrë që të arrihen individët e cënueshëm dhe të mbështeten në rrethana të vështira.

Gjendja me profesionistët e kujdesit shëndetësor duket të jetë disi më ndryshe. Përderisa profesionistët shëndetësorë kanë një njohuri më të mirë të terminologjisë, sa i përket trajtimit dhe çështjeve që lidhen me personat transgjnorë, opinion i tyre nuk është edhe aq pozitiv apo gjithëpërfshirës. Një numër i profesionistëve as nuk e pranojnë se ata kanë ndonjë rol në mbështetjen e personave transgjnorë ose ishin haptazi kundër të drejtës së tyre për të shprehur identitetin e tyre gjinor apo për t'i ndihmuar të bëjnë këtë. Kishte edhe një numër të kufizuar të profesionistëve shëndetësorë të cilët kishin përvojë të drejtpërdrejtë në trajtimin e pacientëve transgjnorë por e pranuan se rrethanat me të cilat përballen pjesëtarët e këtij komuniteti janë të vështira dhe disa prej tyre kishin vërejtur diskursin publik që po zë vend kohëve të fundit lidhur me komunitetin LGBTI.


Të dy grupet e profesionistëve deklaruan se vlerësojnë dobinë e punës multidisiplinare dhe do të ishin të interesuar në futjen e saj në përdorim në ofrimin e shërbimeve. Kjo do të përfshinte organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime, edhe pse shumë prej tyre nuk e dinin se cilat organizata janë të fokusuar në këto çështje. Në lidhje me dy grupet ka pasur një interes në ndjekjen e trajnimeve për informata të përditësuara lidhur me qasjen e tyre kur punojnë me persona transgjnorë si dhe ishin të interesuar të kenë qasje në dokumentet e standardeve të zhvilluara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

REKOMANDIME

1. Institucionet publike duhet të vazhdojnë të punojnë me shoqërinë civile në ngritjen e vetëdijes dhe pranueshmërisë së personave transgjnorë;
2. Institucionet relevante duhet të rishikojnë legjislacionin primar dhe sekondar për t'i mundësuar personave transgjnorë ndryshimin e shenjave identifikuese të gjinisë në dokumente. Për shembull Ministria e Punëve të Brendshme duhet të sigurojë që të themelohen procedurat relevante për ta mundësuar këtë;
3. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të përfshijë në strategjinë e saj gjendjen e vështirë të personave transgjnorë dhe të punojë me departamentet e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Qendrat për Punë Sociale që të ofrojnë burime dhe shërbime të mjaftueshme që mund të kërkohen nga personat transgjnorë, siç është këshillimi;
4. Qendrat për Punë Sociale duhet që vazhdimisht të rishikojnë nevojat e personave transgjnorë, t'i përfshijnë këto në planet vjetore si dhe të ofrojnë shërbime si këshillim apo akomodim/ndihmë materiale në raste emergjente atëherë kur është e nevojshme;
5. Ministria e Shëndetësisë gjithashtu duhet të përfshijë në strategjinë e saj nevojat e personave transgjnorë me qëllim të sigurimit që shërbimet për personat transgjnorë të jenë në dispozicion. Kjo do të përfshinte trajtimet që personat transgjnorë do të mund t'i kërkonin, si terapitë hormonale dhe/ose ndërhyrjet kirurgjike për ndërrimin e gjinisë.
6. Organizatat e shoqërisë civile duhet të vazhdojnë punën me personat transgjnorë për t'i ofruar shërbime kudo që është e mundur, si dhe në ngritjen e vetëdijes;
7. Institucionet publike si dhe punëtorët socialë dhe profesionistët shëndetësorë duhet të përqafojnë punën multi-disciplinare për të siguruar arritjen e rezultateve më të mira për personat transgjnorë përfshirë këtu edhe punën me shoqërinë civile;
8. Shoqëria civile duhet të punojë me punëtorët socialë dhe profesionistët shëndetësorë për të ofruar trajnime lidhur me të drejtat e personave transgjnorë si dhe në ofrimin e përdorimit të të dhënave të fundit prej dokumenteve dhe protokoleve të standardeve;
9. Të gjitha institucionet duhet të sigurojnë që konfidencialiteti respektohet dhe mbrohet në të gjitha procedurat e mbrojtjes sociale si dhe në kujdes shëndetësor. Duhet të nxirren protokole për mbrojtjen e të dhënave nëse tanimë nuk ekzistojnë në Qendrat për Punë Sociale dhe spitale dhe kur është e nevojshme duhet të kërkohet bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave.

Për më tepër Koalicioni ERAC do të përkushtohet që si pjesë e strategjisë avokuese:

1. Të organizojë takime me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Institucionin e Avokatit të Popullit për të diskutuar të gjeturat e këtij raporti në hollësi dhe për të shqyrtuar mënyrat e bashkëpunimit përmes ERAC për t'i mbushur boshllëqet e identifikuar;
2. Të shqyrtojë në mënyrë të vazhdueshme mënyrat për ngritjen e vetëdijes për çështjet e komunitetit transgjnorë qoftë në takime me zyrtarë publikë, paraqitje mediatike apo diskutime publike;
3. Të ofrojë trajnime për punëtorët socialë lidhur me personat transgjnorë dhe nevojat e tyre;
4. Të punojë me profesionistët shëndetësorë në lidhje me zhvillimet e fundit dhe ofrimin e dokumenteve të standardeve që do t'i ndihmonë në trajtim;
5. Të ofrojë mbështetje për personat transgjnorë kur nevojitet;
6. Të zhvillojë një formë të monitorimit në veçanti në lidhje me rastet ku kontaktohen institucionet lidhur me rastet specifike apo kur ofrohet mbështetje lidhur me të drejtat e personave transgjnorë.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë